

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7373 E hënë 4 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga MONIKA SHOSHORI STAFA

Kur natyra hakmerret



Tri ditët e fundit Shqipëria është e zhytur në ujë nga moti i rënduar me reshje të mëdha të shiut. Situata është problematike në të gjithë vendin. Përmbytjet masive...
Vijon në faqet 18-19

Opinion i Ditës

Nga SHABAN MURATI



Nuk besoj se ka ndodhur ndonjëherë në historinë diplomatike të Ballkanit, e ndoshta edhe të Europës, që brenda dy muajve një grup i ngushtë rajonal shtetesh të...
Vijon në faqen 21

Formati i "Traktatit të Bukureshtit" në Beograd dhe Shqipëria



Si u përfshinë në aksident 4 makinat, situata

Bilanc përmbytjesh, u evakuuan 596 familje, 3,337 banesa nën ujë në mbarë vendin

Kryeministri në Kutalli: Shqipërinë s'e kemi "Ferrari". Basha: Qeveria ju braktisi

Moti në vendin tonë ka ardhur drejt përmirësimit, reshjet e shiut janë pakësuar dhe vendin e tyre e kanë zënë bora në zonat malore. Zvogëlimi i prurjeve dhe tërheqja e ujrave ka ulur rrezikun kryesor nga lumi Vjosë në Vlorë dhe Fier. Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave raportoi tje...
Në faqet 2-5

PROJEKTIGJI, SI MUND TE APLIKONI VETEM NE NJE NDER PROGRAMET E SHTETIT

TE PREKURIT NGA PERMBYTJET, JA KUSH PERFITON STREHIMIN

Kushtet e dokumentacioni që duhet dorëzuar për të marrë shtëpi nga shteti. Përzgjedhja dhe kategoritë. Shkollat rinisin mësimin, përjashtimet



(Në foto) Situata e përmbytjeve të ditëve të fundit në vend

ME ÇFARE LIDHEN

Elbasan, prokurores i humbasin tri dosje hetimore të korrupsionit

Në faqen 10

INTERVISTA

Flamur Hoxha: Një jetë në internim e lidhja ime me Partinë Demokratike

Në faqet 8-9

MESAZHI

Presidenti, një ditë ndryshe me njerëzit që kanë aftësi të kufizuara

Në faqen 12

SUPERLIGA

Spektakël i kurbinasve, përmbysin disavantazhin.

Partizani dhe Laçi, suksese në transferitë

Në faqen 22

PROJEKT MBESHETES



Riatdhesimi, sa paguhen familjet e individët për të ikur nga Gjermania

Në faqen 11


Dermatologia Fida: Sekretet për një lëkurë 20 vite më të re, si të eliminoni rrudhat

Ylli Merja: Si të ulni kolesterolin në një muaj

Këshilla të vlefshme për t'u mbrojtur nga situatat e përmbytjeve

Nga VOLTIZA DURO

Plakja e lëkurës dhe rrudhat janë ndër shenjat që vitet lënë pas, proces ky i pashmangshëm, por që ndikohet edhe nga një sërë faktorësh të jashtëm. Ekspozimi gjatë nën rrezet e diellit, pirja e duhanit dhe alkoolit, por



edhe preka nga pluhuri përshpejtojnë procesin e plakjes së lëkurës dhe krijimin e rrudhave, aq të padëshiruara, veçanërisht nga femrat. Në një intervistë ekskluzive për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", dermatologia...

Suplement

PERMBYTJET SITUATA NE VEND

"U prishën dhe u dëmtuan 28 ura dhe shumë pjesë aksesh rrugore"

Përmbytjet, EC: U evakuuan 596 familje dhe u shpëtuan 1,552 qytetarë

"Janë përmbytur 3,337 banesa në mbarë vendin"

TIRANE

Moti në vendin tonë ka ardhur drejt përmirësimit, reshjet e shiut janë pakësuar dhe vendin e tyre a kanë zënë bora në zonat malore. Zvogëlimi i prurjeve dhe tërheqja e ujërave ka ulur rrezikun kryesor nga lumi Vjosë në Vlorë dhe Fier. Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave raportoi dje në mesditë se strukturat shtetërore janë angazhuar pa ndërprerje, me fokus kryesor shpëtimin e jetëve dhe minimizimin e dëmeve. Gjithashtu, është bërë i mundur evakuimi i qytetarëve nga zonat e rrezikuara, si dhe është punuar me forca dhe mjete të shtuara për kthimin sa më shpejt në normalitet. Emergjencat Civile bëjnë me dije se zona më e rrezikuar si dhe përpjekja kryesore është zhvilluar për të mbrojtur funksionimin e hidrovorit në Darëzëzë të Fierit. Përpjekjet e shumta bënë të mundur që të mbrohet hidrovorin nga përmbytja, duke shmangur kështu pasojat të konsiderueshme. Bëhet me dije se deri tani janë evakuuar 596 familje dhe janë shpëtuar 1,552 qytetarë. Gjenden të përmbytura 10,217 ha tokë, kryesisht në Fier dhe Vlorë, si dhe 5,781 ha me prani uji. Banesa të përshkuara nga uji dhe të përmbytura janë 3,337 në mbarë vendin. Ndërkohë, Emergjencat Civile njoftojnë se rrugët janë të hapura, me përjashtim të disa rrugëve dytësore e rurale, ku po vijon puna për normalizimin e trafikut. Gjithsesi, përmbytjet kanë shkaktuar dëme permanente në infrastrukturë, si prishjen apo dëmtimin e 28 urave dhe shumë pjesë aksesh rrugore. Shkatërrimi i urave është një ndër fenomenet e veçanta të emergjencës aktuale, që në ndryshim në ato të mëparshmet, lidhet me furinë e jashtëzakonshme të prurjeve të ujit, të shkaktuar nga intensiteti i jashtëzakonshëm i reshjeve. Si rrjedhojë e punës së përkushtuar të OSHEE, është arritur të minimizohet numri i abonentëve pa energji. Dëme janë regjistruar edhe në shkollat e ciklit të ulët e si rrjedhojë të hënën nuk mund të rifillojë mësimi në 56 shkolla në mbarë vendin. Krahas menaxhimit të emergjencës, ka filluar edhe inventarizimi i dëmeve të shkaktuara.

MASAT E SIGURISË

Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave u bën thirrje të gjithë qytetarëve për kujdes të shtuar gjatë situatës së reshjeve dhe përmbytjeve, duke pasur vëmendje sidomos në kujdesin për jetën, që mbetet prioriteti i dorës së parë. Të gjithë duhet të shmangin sa më shumë të jetë e mundur udhëtimet në zonat e prekura nga reshjet,

qëndrimin në afërsi të lumenjve e përrrenjve, qëndrimin afër shtyllave apo objekteve të tjera të larta që mund të goditen nga shkarkesat elektrike etj. Qytetarët që banojnë shumë pranë shtretërve të lumenjve, në afërsi të digave apo në zona që historikisht rrezikojnë përmbytje, duhet të shtojnë kujdesin për jetën dhe të jenë në gatishmëri për të bashkëpunuar me strukturat e Emergjencave Civile në rast të nevojës për evakuim të përkohshëm.

Kërkohej të shmangen në maksimum udhëtimet në këmbë apo me automjetet në zonat e prekura apo me rreziq të prekjes nga përmbytjet. Një rrymë uji me thellësi rreth 20 centimetra mund të rrezikojë një kalimtar ndërkohë që një rrymë me thellësi prej 30 centimetra mund të rrezikojë automjetin gjatë udhëtimit. Bëhet me dije se duhet të shmangen në maksimum kalimet në urat e lu-



STATISTIKAT

- Janë evakuuar 596 familje.
- Janë shpëtuar 1,552 qytetarë.
- Janë përmbytur 10,217 ha tokë, kryesisht në Fier dhe Vlorë.
- Ndodhen 5,781 ha tokë me prani uji.
- Janë përshkuar nga uji dhe janë përmbytur 3,337 banesa në mbarë vendin.
- Janë prishur dhe dëmtuar 28 ura dhe shumë pjesë aksesh rrugore.

TROPOJË


Në rrethin e Tropojës përveç dëmeve që solli shiu i madh, probleme ka sjellë edhe dëborja. Rrugët e dëmtuara nga shembjet masive në fshatrat Geghyzen e Degë janë riparuar në kohë rekord dhe janë tërësisht të kalueshme. Ndërsa shtatë urat e prishura në disa fshatra akoma nuk janë në funksion për arsye fondesh.

LUMI VJOSË

Lumi Vjosë është tërhequr mëngjesin e djeshëm, ndërkohë që po dalin në pah edhe dëmet e para. Përveç përmbytjes së banesave dhe tokave, edhe argjinatura e shinave të trenit është dëmtuar në një gjatësi prej 70 metrash, ku dalja e lumit ka krijuar erozione. Shtabi i emergjencës ka vëzhguar nga afër bregun e Vjosës në fshatin Mifol. Prefekti Flamur Mamaj dhe kryetari i bashkisë, Dritan Leli bënë të ditur se do të kryhet sa më shpejt një ndërhyrje emergjente pranë kësaj argjinature, me qëllim pastrimin dhe përforcimin e saj.



menjve me prurje të shtuar dhe rryma të fuqishme. Emergjencat Civile njoftojnë se nëse niveli i ujit në afërsi



ARRSH

AKSI LEVAN-TEPELENË

Si pasojë e shirave të dendur të ditëve të fundit, Autoriteti Rrugor Shqiptar njoftoi dje se në aksin rrugor Levan-Tepelenë ka prezencë uji në rrugë në afërsi të fshatit Selishtë. Rruga është e kalueshme nën monitorimin e punonjësve të ARRSH, kontraktorit të mirëmbajtjes dhe Policisë Rrugore.



Banorët

GJIROKASTËR

Banorët e lagjes "Zinxhira" në Gjirokastrë, në kufi me Lazaratin kanë shprehur shqetësim mbi prurjet e mëdha të përoit, i cili u ka përmbytur banesat, ndërkohë ata apelojnë për ndihmë. Sakaq, mësohet se situata në pjesën më të madhe të qarkut të Gjirokastrës është përmirësuar dhe rrugët kryesore janë të hapura.

të automjetit rritet, por mjeti nuk lëviz, duhet të lihet automjeti për të gjetur një vend më të lartë. Gjithashtu, duhet të shmangjet parkimi i automjetit në afërsi të lumenjve apo përrrenjve gjatë reshjeve të rënda, pasi ato mund të përmbyten shumë shpejt.

Të shmangen qëndrimet apo parkimet në rrugët që janë në buzë të lumenjve. Shpeshherë ujërat mund të gërryjnë bazamentin e rrugës, duke e bërë atë të rrezikshme. Ndërsa duhet të mbahen hapur radiot apo

televizori për të marrë njoftimet që mund të jepen nga autoritetet kompetente. Emergjencat Civile njoftojnë se është e rëndësishme që shtetasit të mbajnë në gatishmëri mjete të ndihmës së shpejtë, medikamente të domosdoshme, mjete ndricimi etj. Të shkëputen sa më shumë pajisje elektrike nga rrjeti dhe të mos preken nëse janë në lagështi ose nën ujë. Gjithashtu, shtetasit duhet të kenë kujdes nga goditjet elektrike, që mund të vijnë nga rënia e telave të tensionit në pellgjet me ujë.



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, ishte dje në Novoselë për të inspektuar nga afër situatën e shkakuar nga përmbytjet, pas daljes nga shtrati të lumit Vjosë. Sipas tij, në terren ndodhen 2200 forcat policore, të cilat në bashkëpunim me ushtrinë dhe grupet e ardhura nga Kosova përballojnë me sukses situatën e vështirë. I pyetur për vazhdimësinë e operacionit, Xhafaj theksoi se për momentin, detyra kryesore e policisë është të shpëtojë jetët njerëzore. "Së pari, detyra numër një e Forcave Speciale është të shpëtojë jetët njerëzore. Së dyti, të mundësojnë të ketë sa më pak dëme materiale, përfshirë këtu pjesën e bagëtive. Dhe së treti, natyrisht të ndihmojnë operacionin

"Prioritet, evitimi i humbjes së jetëve njerëzore"

Përmbytjet, Xhafaj "zbarkon" në Novoselë: 2200 forca të angazhuara në terren



Fatmir Xhafaj, dje në Novoselë

e shpërndarjes së ndihmave. Për momentin duhet të përballojmë fazën e parë, të evitojmë humbjen e jetëve njerëzore", tha ministri i

Brendshëm, Xhafaj. Ai foli edhe për operacione të vështira ku u angazhuan forcat policore, të cilat vunë në rrezik jetën e tyre, për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve. "Të paktën ju vetë keni dhënë shembuj konkretë ku janë kërcënuar jetët njerëzore, kanë qenë në vështirësi ekstreme të lëvizjes dhe është dashur ndërhyrja e forcave operacionale për t'i shpëtuar përmes operacioneve shumë të vështira, duke sakrifikuar jetët e tyre në funksion të jetëve të njerëzve", u shpreh Xhafaj. Më tej, ankesave të banorëve për mungesën e energjisë elektrike, ministri iu përgjigj se ndërprerja është e domos-

FATMIR XHAFAJ
Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj u shpreh se në terren ndodhen 2200 forcat policore, të cilat në bashkëpunim me ushtrinë dhe grupet e ardhura nga Kosova përballojnë me sukses situatën e vështirë.

doshme për arsye sigurie. Gjatë inspektimit, Xhafaj shoqërohej nga drejtori i Përgjithshëm i Emergjencave Civile, Shemsit Preçi dhe kryebashkiaku i Vlorës, Dritan Leli.

Ministrja Xhaçka: Situata është përmirësuar, lumenjtë nuk rrezikojnë më përmbytjet

Shembet ura në fshatin Darzezë, izolohen 400 familje

Nis rindërtimi provizor, forcohet argjinatura e kanalit

Ina Allkanjari

FIER

Operacionet për të përballuar situatën e vështirë të krijuar nga moti i keq vazhdojnë në jug të vendit. Disa fshatra në Fier dhe Vlorë janë nën pushtetin e ujit. Prurjet e lumit kanë përmbytur totalisht 2 fshatrat e Fierit, Darzezë dhe Povelçë, të Njësisë Administrative Dërmnas. Ditën e djeshme prezenca e ujit është tërhequr jo pak dhe rruga është bërë e kalueshme për fuoristradat, por gjithësi rreziku mbetet evident. Si pasojë e shembjes së urës në orët e para të mëngjesit të djeshëm, kanë mbetur të izoluar 400 familje të Darzezës.

Rreth 40 efektivë të Forcave të Armatosura vijnë që prej mbrëmjes së të shtunës të qëndrojnë në Darzezë të Fierit, të cilët kanë vendosur thasë me rërë në të dy anët e argjinaturës së kanalit kullues, si dhe po ndihmojnë banorët e prekur nga përmbytjet. Ndërkohë në orët e vona të mbrëmjes së djeshme mësohet se kanë mbërritur pjesët e urës provizore në Darzezë. Forcat xhenio të ushtrisë vazhduan punimet gjatë natës për montimin e urës, e cila do të mundësojë edhe kalimin e mjeteve nga




Ura e shembur në Darzezë



VIKTIMA E PARË

Një ambulancë është përmbytur në Laç 3 ditë më parë, ndërsa ka humbur jetën personi që shoqëronte të sëmurin. Ambulanca ka dalë nga rruga si pasojë e lagështirës, ndërsa ishte duke udhëtuar nga Burreli drejt Tiranës. Personi që ka humbur jetën shoqëronte nënën për në spital. Mësohet se viktima është Afrim Dami, 50-vjeçar.



DËBORA/KUKËS

Qarku i Kukësit është përfshirë nga dëbora. Reshjet ditën e djeshme arritën 4 cm, ndërsa në rajonin e Valbonës dhe Qafë-Shllak rreth 30 cm. Aktualisht të gjitha akset rrugore që përshkojnë Qarkun e Kukësit janë të qarkullueshme pa zinxhirë. Si pasojë e kushteve atmosferike, një pjesë e konsiderueshme e qarkut të Kukësit vijon pa energji elektrike.

aksi rrugor deri në fshatin Darzezës së Fierit. Bëhet me dije se fadromat po hedhin gurë për të parandaluar gërryerjen e mëtejshme të kanalit, ndërsa pritet të vendoset edhe ura metalike. Ministrja Olta Xhaçka, e cila

ndodhet që prej mbrëmjes së të shtunës në këtë zonë po monitoron situatën. Xhaçka tha se situata është përmirësuar dhe lumenjtë nuk rrezikojnë më përmbytje. Ajo u shpreh se forcat e FA dhe punonjësit e institucioneve

të tjera qëndrojnë 24 orë në gatishmëri. "Situata është përmirësuar. Lumenjtë nuk rrezikojnë më përmbytje. Janë evakuuar rreth 60 familje. Akset kryesore janë të lira. Kemi problematikë për disa ura të shembura,

INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit bën me dije se situata po fillon të normalizohet dhe rreziku i përmbytjeve ka kaluar. Gjatë ditës së djeshme lumi Vjosa u tërhoq dhe për këtë arsye janë hequr paralajmërimet për përmbytje. Ndërkohë, reshjet e shiut do të vazhdojnë, por me intensitet më të ulët.



por prezenca më e madhe ka qenë më e madhe në Darzezë. 6 elektropompa janë vendosur në funksion dhe FA kanë punuar për të mbrojtur argjinaturën e lumit. Kemi pasur bashkëpunim me të gjithë aktorët dhe kemi pasur mbështetje edhe nga Kosova. Kemi bërë të mundur që situatën ta menaxhojmë më mirë. Grupet e FA dhe të gjithë punonjësit e institucioneve qëndrojnë 24 orë në gatishmëri për të ndihmuar qytetarët në Darzezë. Jemi natë ditë në punë për të ndihmuar të gjithë të prekurit.

DUKAGJIN

Rreth 300 familje janë izoluar totalisht si pasojë e reshjeve të borës në zonën e Dukagjinit. Bora ka bllokuar rrugën nga Mali Shoshit deri në Qafë-Thore. Banorët e mbetur në izolim bëjnë të ditur se të dyja rrugët që lidhin Shkodrën me Dukagjinin janë bllokuar. Në aksin Qafë Thore-Theth ka rreth 60 cm borë dhe nuk mund të kalohet as me mjete me zinxhir dhe as në këmbë.



Nuk do kemi agravim të situatës për ditët në vijim dhe pjesa e emergjencës ka kaluar", - tha Xhaçka. Ndërkohë, edhe kreu i Bashkisë Fier, Armando Subashi tha se pushteti vendor ka marrë masat për të mos pasur probleme. "Situata është në nivele kritike, por është në kontroll. Të gjithë jemi në këmbë me Forcat e Armatosura, me bashkinë dhe besoj se situatën do ta kalojmë me sukses. Ujërat janë në nivele të konsiderueshme, por besoj se nuk do kemi probleme me masat që janë marrë", - tha Subashi.

PERMBYTJET SITUATA

Kreu i PD shoqërohet nga kryebashkiaku socialist, përgëzon ushtarët në terren

Basha, në Fier e Novoselë: Situata alarmante, qeveria braktisi qytetarët

Banorët: S'kemi ujë të pijshëm, s'kemi marrë asnjë ndihmë

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, inspektoi dje në Fier fshatin e Darëzës dhe në Ferras, dy nga zonat më të prekura nga përmbytjet, si pasojë e daljes nga shtrati të lumit të Vjosës. Z.Basha është njohur me situatën problematike të shoqëruar nga kryebashkiaku i PS, Armando Subashi. Kreu demokrat përmes një postimi në "Facebook" bëri thirrje për ndihma për banorët në këto momente kritike, të cilët kanë lënë shtëpitë e tyre për shkak të vërshimit të ujërave. Basha pohoi se të hyjë në fshat ishte e pamundur, pas përmbytjeve të shkaktuara nga reshjet e shiut. Mes të tjerash, ai theksoi se kryebashkiaku i Fierit, Armando Subashi e kishte njohur me situatën dhe masat e marra. "Në Darëzë, në Fier, futja në fshat ishte e pamundur. Fshati i përmbytur ishte i izoluar nga shkatërrimi i rrugës. Transporti i banorëve bëhej me varka. Përgëzova ushtarët që po punonin për rivendosjen e lidhjes mes zonës së përmbytur dhe pjesët tjetër të Fierit. Kryebashkiaku Armando Subashi më njohu me masat e marra për shpëtimin e njerëzve. Tani që reshjet treditore janë në minimum, është emergjente ndihma me ushqime, veshje dhe strehim për zonat e përmbytura", deklaroi z.Basha. Kryetari i PD-së ndaloi edhe në Ferras të Fierit, duke e cilësuar situatën alarmante. Basha deklaroi se në këtë fshat të Fierit, situata është alarmante dhe banorët ankohen se janë braktisur nga qeveria dhe nuk kanë marrë asnjë ndihmë. Spas kryedemokratit, furnizimi me ujë të pijshëm për banorët në Ferras është nevojë urgjente. "Situata alarmante. Banorët ankohen se janë braktisur nga qeveria dhe se nuk kanë marrë asnjë ndihmë. Furnizimi me ujë të pijshëm për banorët në Ferras është nevojë urgjente"



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje në Fier

LULZIM BASHA

"Situata alarmante. Banorët ankohen se janë braktisur nga qeveria dhe se nuk kanë marrë asnjë ndihmë. Furnizimi me ujë të pijshëm për banorët në Ferras është nevojë urgjente"

"Piktori bëri që Tiranë-Durrës ta përshkosh me gomone"

Berisha: Gjendje dramatike në Çerven Kafaraj të Fierit

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi sërish dje shqetësimet e ardhura nga qytetarët të ndryshëm nga mbarë vendi, të prekur nga përmbytjet në disa qytete të vendit. Berisha publikoi në faqen e tij në "Facebook" një mesazh të një banori në Çerven Kafaraj të Fierit. Ai theksoi se situata aty është dramatike. "Gjendje dramatike në Çerven Kafaraj, Fier! Sb 'Kjo është e vërteta e situatës në Çerven Kafaraj, njësi Frakull. Ai i gjati nuk di çfarë thotë, gjendja këtu është më keq se në 2015-ën. Madje, shumë herë e keq", thuhet në mesazhin dërguar z.Berisha. Ish-



Ish-kryeministri Sali Berisha

kryeministri po dje publikoi mesazhin e qytetarit dixhital për situatën në autostradën Tiranë-Durrës, për shkak të përmbytjeve. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Berisha përcjell edhe një foto nga autostrada e mbuluar nga uji. "Qytetari dixhital ka një urim për pik-

torin dështak, për suksesin e tij më të fundit. Lexoni urimin e tij! SB "Ta përgëzojmë piktorin, i cili bëri të mundur që Tiranë-Durrës ta përshkosh me gomone, jo vetëm me makina", thuhet në mesazhin dërguar ish-kryeministrit Sali Berisha.

të gjithë personat. Këtu kemi llogaritë bankare dhe dëmin e vitit 2015 dhe asnjë gjë nuk na ka dëmshpërblyer. Mbetën ato... Ndërsa tani nuk na vjen njeri të na shikojë", i tha një banor, kreut të PD-së. Më herët, kreu i PD-së me anë të një postimi në "Facebook" publikoi denoncimin e një qytetari nga Fier. Spas mesazhit që ka publikuar Basha, Vjosa ka dalë nga shtrati dhe banorëve nuk u



Kryeministri Edi Rama dje në Kutalli

TRITAN SHEHU

Deputeti i PD-së, Tritan Shehu ishte në një nga zonat më të dëmtuara nga përmbytjet në Gjirokastër. Bizneset në qytet kanë pësuar dëme të mëdha, ndërsa Dropulli është pothuajë izoluar. Shehu kërkoi që bashkia dhe qeveria t'i ndihmojnë qytetarët me ndihmë financiare.

Përmbytjet, Malltezi: 5 gjërat që nuk bëri qeveria

Kreu i Departamentit të Mjedisit në PD, Jamarbër Malltezi, e cilëson të turpshme situatën e përmbytjeve në vend dhe fajtor për të gjithën këtë bën kryeministrin Rama. Ai renditi 5 pika në të cilat nxjerr zbuluar të gjitha defektet dhe mashtrimet e qeverisë, çka kanë sjellë këtë situatë sot në Shqipëri. "1. Në përmbytjet e 2015-ës, Edi Rama u kap në gënjeshtrë kur deklaroi se kishte investuar në kullime sa 20 vjet të marra së bashku dhe i treguam se në fakt, buxheti faktik i 2014-ës për kullimin ishte 10% më i ulët se 2013-ta! U detyrua ta modifikonte gënjeshtrën më pas se kinshe po thoshte se pas përmbytjeve do investonte sa për 20 vite bashkë, por sot të gjithë shqiptarët janë dëshmitarë edhe të kësaj gënjeshtrë. 2. Nuk pranoi të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në 2015-ën dhe nuk pranoi ta shpallë as tani. Nuk pranoi të dëmshpërblejë asnjë familje as qindarka, ndërsa me ministrat e tij po vjedh qindra milionë euro me aferat e inceneratorëve. 3. Nuk ka marrë masat e duhura për hapjen e kanaleve të kullimit, përdërisa u mbyt vendi me vëç 2 ditë shi dhe pa rrebeshe të mëdha. 4. Fondi për Emergjencat Civile është 1.3 milionë euro, fiks sa ç'është bonusi i vjedhjes që ndajne çdo vit me Vilmen për analizat e pakryera, ndërsa fondi për të zëvendësuar gomarllëkun e Ramës me palmat është plot 2.5 milionë euro! Vetëm vjedhja e parave nga afëra e inceneratorit me çelësa në dorë të Fierit është sa 10 vite të fondit të emergjencave! 5. Qysh 3 ditë përpara njoftuan italianët dhe grekët për përmbytjet dhe masat parandaluese. Asnjë masë parandaluese nuk mori qeveria dhe madje asnjë paralajmërim për bllokimin e autostradës Tiranë-Durrës, kur lëshoi ujë e rezervuarit të Kasharit dhe përmbyti me autostradë dhe biznese", shkruan z.Malltezi.

përgjigjet askush edhe pse janë nën ujë. "SOS nga Fieri! Jam Bujar Varfaj nga fshati Povelcë, komuna Dermentas në rrethin e Fierit. Tani sa erdhi uji i lumit Vjosë, por nuk po na përgjigjet asnjë institucion i shtetit, këtu në fshat ka vajtur një metër ujë. Faleminderit!", thuhet në mesazhin dërguar z.Basha. Dy ditë më parë, kryedemokrati Lulzim Basha vizitoi zonën e përmbytur në Fushë-Krujë.

Ai ka parë nga afër situatën dhe dëmet e shkaktuara në shumë familje, për shkak të përmbytjeve. Kreu i opozitës kërkoi të ndihmohen familjet eprekura. PD njoftoi se Basha ka shkruar edhe në Bilaj, ku emergjencat civile kanë vepruar me vonesë. "Në Fushë-Krujë janë përmbytur 2 lagje me 1500 banorë dhe tërësisht 3 fshatra me zonën e Bubqit, me 100 shtëpi dhe 600 ha tokë", - tha Lulzim Basha.



Kryeministri Edi Rama falënderoi sërish kryetarin e PD, Lulzim Basha, i cili dje ishte në zonat e përmbytura të Fierit, duke inspektuar situatën në fshatin Darëzëzë, i shoqëruar nga kryebashkiaku socialist, Armando Subashi. "Gjithkush prej nesh mund të bëjë punë të mira dhe kur dikush e bën një punë të mirë, sado e vogël a e madhe qoftë, duhet falënderuar e respektuar për atë punë, pavarësisht nëse në jetën e përditshme mendojmë njësoj a mendojmë krejt ndryshe", shkruan Rama në "Facebook". Kryeministri Rama ndoqi nga afër mesditën e djeshme situatën në Urën Vajgurore. Gjatë takimit me banorët të zonës, ata e kanë falënderuar për investimet e bëra, falë të cilave u mbrojtën nga dalja e lumit. "Në Urën Vajgurore ku falë investimeve të kryera për mbrojtjen nga lumi, banesat e fshat bujqësorë që përmbyteshin çdo dimër dhe kaluan një situatë katastrofike në 2015, këtë herë nuk janë prekur, megjithëse prurjet e lumit kanë qenë më të larta", shkruan kryeministri Rama, teksa përcjellë pamje nga takimi. Gjatë inspektimit në qytetin e Berat, kryeministri u prit nga kryebashkiaku i LSI-së, Petrit Sina, i cili u shpreh se nga investimet e bëra nga qeveria dhe nga pushteti vendor këtë vit nuk pati dëme si në vitet më parë. Rama shoqërohej nga ministri i Mjedisit, Klosi, i cili u shpreh se në datë 16 do të fillojë pastrimin i qytetit dhe do të mbillet një sasi e konsiderueshme pemësh në të dyja krahet e lumit, të cilat kanë qenë ekzistuese, por janë prerë. Sipas kryetarit të bashkisë, në një pjesë të qytetit uji arriti deri në 50 cm lartësi, por falë investimeve të bëra, nuk pati rrezikshmëri si në vitin 2015. Në videon e postuar në "Facebook", Rama shkruante se, "falë kolektorëve të rinj që u ndëruan përmes Programit Kombehtar të Rilindjes Urbane, u përballua më mirë se asnjëherë tjetër prurja e lumit, e cila preku nivelin historik të vitit 1962, siç e tregon pllaka përkujtimore e katastrofës natyrore të atij viti. Respekt e mirënjohje të gjitha forcave që janë angazhuar non stop prej 72-orësh në Berat, si në çdo zonë tjetër të prekur nga

Përmbytjet, kryeministri falënderon Bashën: Kur dikush bën një punë të mirë

Batutat, Rama në Kutalli: Shqipërinë s'e kemi "Ferrari"

"Investimet e qeverisë shmangën dëme të mëdha"



Kryeministri Edi Rama dje me banorët e Urës Vajgurore

BATUTA

Z. Rama dje në Kutalli nuk harroi të thumbojë qytetarin dixhital kur takoi një person pranë një kanali. Kryeministri i ka thënë banorit që të largohet që aty se do të bjerë dhe më pas qytetari dixhital do të thotë që e mbyti Rama.

XHAÇKA



"Jemi pranë çdokujt që i rrezikohet jeta"

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka po ndjek nga afër situatën në hidrovorin e Darëzëzës në Fier. Mësohet se aktualisht niveli i ujit ka rënë, por situata po mbahet në kontroll. Ndërkohë në Darëzëzë që prej mbrëmjes së djeshme ndodhen 40 efektivë të Forcave të Armatosura në gatishmëri për ndërhyrje në rast nevojë. "Jemi në këmbë të gjithë për t'u siguruar që hidrovari të mos dalë jashtë funksioni, argjinatura të përforcohet e të merren masa në rast emergjente për 400 familjet që preken të parat nga përmbytja e mundshme. Përgjegjësi maksimale për të parandaluar sa mundemi e për t'i gjendur pranë gjithkujt që i rrezikohet jeta dhe pronat", tha ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka.

Qeveria, fond emergjence për riparimin e dëmeve

Ahmetaj në Kavajë: Investimet minimizuan dëmet nga përmbytjet

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj ishte dje në fshatin Rrikaj të Kavajës, ku u takua me banorët e prekur nga shirat e ditëve të fundit. Në maj 2017 filloi faza e parë e investimit për pastrimin e segmentit prej 6 km të kanalit përgjatë përroit të Darcit, pas më shumë se 25 vitesh harrës. Si rezultat i këtij investimi, zonat e banuara përgjatë këtij segmenti nuk janë prekur nga përmbytjet e ditëve të fundit. Problem mbetet segmenti i dytë, puna për pastrimin e të cilit, sikurse premtoi ministri, do të fillojë në vitin 2018. Përroi me një gjatësi rreth 18,5 km prek zonat në 5 njësi administrative ndërmjet Kavajës dhe Rrogzohinës dhe në vitet e fundit ka përmbytur mbi 2000 ha tokë, duke sjellë dëme të konsiderueshme në banesat, tokën bujqësore, por edhe gjënë e gjallë. "Ajo që vëmë re është se aty ku



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj dje në fshatin Rrikaj të Kavajës

kemi investuar, tek pjesa e parë e kanalit të Darcit, prej mbi 6km, fatmirësisht nuk ka asnjë përmbytje. Pjesa e dytë, pra segmenti i dytë që është planifikuar për t'u pas-truar gjatë vitit 2018, ka problematikën e vet të përmbytjes. Është një zonë me rrjet kanalizimesh, që nuk është prekur për më shumë se 25 vite. Siç e theksova, kemi filluar të investojmë në

pjesën e parë, rezultatet janë të dukshme. E ndërko-hë, duke parë çfarë ka ndodhur këtu, kemi detyrim të vazhdojmë të jemi pranë njerëzve dhe sigurisht që të vazhdojmë investimin e nisur, në mënyrë që të kemi rezultate të dukshme, të për-puthura me ato investime që do të duhet të bëjmë. Dëmet megjithëse janë të vogla, sig-urisht që ka, në shtëpi, në

FONDI

"Duke qenë afër njerëzve, ashtu si e gjithë qeveria, të gjitha institucionet, për t'ua lehtësuar sa më shumë atë ngarkesë që kanë këto ditë, edhe Bashkisë së Kavajës nesër (sot) do t'i akordohet një fond emergjence për të reaguuar në pastrimin e kanaleve dytësore, për ta lehtësuar situatën", - tha Ahmetaj.

ujit". Kurse pasditën e djeshme, kryeministri Rama ishte për inspektimin e situatës në zonën e Kutallisë në Berat. Rama ka thënë se puna që ka bërë qeveria me pastrimin e kanaleve kulluese është faktori kryesor që këtë vit nuk pati përmbytje si më parë. Gjithashtu, nuk kanë munguar as batutat që Rama ka bërë me të rinjtë e zonës, të cilët e

kanë pritur kryeministrin me duar në xhepa dhe duke i thënë se njëri prej tyre është me Interin. Si "juventin" që është, Rama i tha që "ti që je me Interin duhet të presësh fundin e kampi-onatit që të shkoni atje ku kemi qenë". Ndërsa një djalë i të veshur me atlete "Adidas" i ka thënë që janë markë e mirë, edhe pse janë bërë me baltë. Rama nuk

harroi as të thumbojë qytetarin dixhital kur takoi një person pranë një kanali. Kryeministri i ka thënë banorit që të largohet që aty se do të bjerë dhe më pas qytetari dixhital do të thotë që e mbyti Rama. Pyetjeve të banorëve si për rrugën dhe për subvencionet, Rama iu përgjigj me kërkesën për të qenë të duruar, pasi me fillimin e zba-

gjë të gjallë, por sërish më duhet të them që në krahasim me vitin 2015, situata është jo në atë ekstremitet, por sigurisht që prezenca e ujit ka prekur shumë shtëpi", - tha Ahmetaj. Bashkisë së Kavajës do t'i akordohet një fond emergjence për vazhdimin e punës për pastrimin e kanaleve dytësore.

timit të buxhetit të vitit 2018, që u miratua dy javë më parë do të nisnin investimet. "Shqipërinë s'e kemi 'Ferrari', e kemi 'Fiat Punto', të vogël, avash-avash", iu tha Rama banorëve. Teksa njëri e ngacmoi për krenun e opozitës Lulzim Basha, Rama i tha: "Po ç'ke me Lulin, Lulin e kemi djale të mire, por është pak i vogël, do rritet".

Përmbuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shijtë ne ankand pasurine :
 *Toka Are truall nr pasurine 222/11 , vol 4 , faqe 83 ne Zonen Kadastrale 3652 ndodhur ne fshatin Trush , Njësia Administrative Berdise , bashkia Shkoder
 Cmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpëshkruar, është në vlerën 736.000 (shiqatëqind e triqjete e gjashtëmijë) lekë
 Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me date 07.12.2017 ora 16.16 në Zyren e përmbuesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Perballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të drejtin përpara fillimit të ankandit 10% të vlerës si garancë ne Bankën BKT deqja Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74.2065 1017.0000.6003.1383.9100.



PROJEKTLIGJI/ Si do të bëhet përzgjedhja, nuk përfitoni dot më shumë se një program

Strehim nga shteti për të prekurit nga përmbytjet, kush përfiton

Kushtet dhe dokumentacioni që duhet dorëzuar

Voltiza Duro

Strehimi social, kategoritë që përfitojnë me përparësi

Për disa kategori të veçanta, kushtet e strehimit, ato sociale dhe familjare përcaktohen me përparësi. Për të gjitha ato familje apo individë që kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, kushtet e strehimit përcaktohen me përparësi. Gjithashtu, përcaktohen me përparësi edhe kushtet sociale për personat me aftësi të kufizuara, jetimët, familjet e policëve të rënë në krye të detyrës, punonjësit e FNSH-së dhe RENEAs, viktimat e trafikimit apo dhunës në familje, si dhe anëtarët e komunitetit rom apo egjiptian. Më tej në projektligj, edhe kategoria e të miturve që kanë përfunduar detyrimin pas konfliktit me ligjin, personat e komunitetit LGBT, vajzat nëna e emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkerkuesit, përcaktohen më me përparësi. Ndërkaq, përcaktimi me përparësi bëhet edhe për kushtet familjare për disa kategori specifike si: familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna; të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore; familjet me më shumë se katër fëmijë; bashkëshortët, moshë e përgjithshme e të cilëve arrin deri në 60 vjeç.

Të gjithë banorët e prekur nga përmbytjet e ditëve të fundit, tashmë mund të aplikojnë për të përfituar në një prej programeve të strehimit, nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara. Në bazë të një projektligji të propozuar e miratuar nga Këshilli i Ministrave, çdo individ mbi 18 vjeç që rezultoi si i pastrehë pasi ka humbur banesën për shkak të fatkeqësive natyrore, përfshirë edhe përmbytjet, mund të strehohet nga shteti. Sipas Emergencave Civile, reshjet e dendura kanë arritur të përshkojnë e të përmbytin plot 3337 banesa në mbarë vendin, duke shkaktuar edhe dëme të mëdha materiale. Familjet e prekura, sipas projektligjit, duhet të përbushin kushtet e paracaktuara në ligj e të jenë të regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore. "Përfshihen në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, vetëm ato individë/familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve në këtë ligj", citohet në projektligjin "Për strehimin social". Këto programe sociale përfshijnë banesat sociale me qira, ato me kosto të ulët, krijimin e banesave të përkohshme, zhvillimin e zonës me qëllim strehimin si dhe përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese deri në një ndërtim të ri. Më tej, në projektligj theksohet se familjet apo individët që nuk kualifikohen si përfittues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër, në rastet kur plotësojnë kushtet ligjore. Ndërkaq, të interesuarit duhet të kenë kujdes, pasi nuk mund të përfitojnë njëkohësisht nga më shumë se një program social.

DOKUMENTACIONI
Aplikantët duhet të dorëzojnë pranë njësisë adminis-



Situata pas përmbytjeve në banesa

trative kërkesën për të përfituar strehim social si dhe dokumentet e kërkuara. Në dosjen e dokumentacionit duhet të përfshihen: kartën e identitetit, vërtetimin për vendbanimin, vërtetimin e të ardhurave neto dhe bruto, vërtetimin nga sigurimet shoqërore për derdhjen e kontributeve dhe organet tatimore, vërtetimin pensioni, vërtetim papunësie, vërtetimin nga zyra e ndihmës sociale, vërtetimin që nuk disponon pronë dhe banesë. Gjithashtu, duhet të bashkëngjisin edhe vërtetimin për personat jetimë, vërtetimin mjekësor për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, vendimin e gjykatës për familjet e divorcuara me fëmijë. Ndërkaq, personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe "azilkerkues" duhet të dorëzojnë dokumentin përkatës. "Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili sigurohet me shpenzimet e vetë një-

sisë së vetëqeverisjes vendore për këta aplikantë", thuhet në vendimin e Këshillit të Ministrave.

PËRZGJEDHJA

Përzgjedhja e kandidatëve që kanë humbur banesën për shkak të fatkeqësive natyrore e që dëshirojnë të përfitojnë nga strehim social bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi. Ky i fundit hartohet, miratohet e publikohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Pas shqyrtimit të kërkesës e dokumentacionit, përzgjidhen të gjithë ata individë apo familje që përbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi. Lista e përfittuesve dhe dokumentacioni përkatës vlerësohet nga komisioni i strehimit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Programet sociale të strehimit ndërthuren me programet tjera të shërbimeve sociale, kryesisht ato të punësimit, arsimimit, kujdesit shëndetësor.

DOKUMENTET PËR TË PËRFITUAR STREHIM SOCIAL

- Karta e identitetit të aplikantit.
- Certifikata personale dhe familjare.
- Vërtetimi për vendbanimin.
- Vërtetimi i të ardhurave neto dhe bruto.
- Vërtetim nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve.
- Vërtetimin nga zyra e ndihmës sociale.
- Vërtetim papunësie.
- Vërtetim pensioni.
- Vërtetimin që nuk disponon pronë dhe banesë.
- Vendimin e gjykatës për familjet e divorcuara me fëmijë.
- Vërtetim për personat jetimë.
- Vërtetim mjekësor për kategorinë PAK.
- Dokumentin për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe "azilkerkues".

KATEGORITË QË PËRCAKTOHEN ME PËRPARËSI

- Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:
 - Nuk disponojnë banesë në pronësi.
 - Banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje.
 - Banojnë në banesa të mbipoplluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.
 - Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore.
 - Familjet ose individët që humbasin banesën si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.
 - Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:
 - Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat-nëna.
 - Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore.
 - Familjet me më shumë se katër fëmijë.
 - Bashkëshortët, moshë e përgjithshme e të cilëve arrin deri në 60 vjeç.
 - Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:
 - Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.
 - Individët me statusin e jetimit, që nga casti i daljes nga qendra e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç.
 - Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve.
 - Emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkerkuesit.
 - Familjet e policëve të rënë në detyrë.
 - Punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH).
 - Punonjësit e repartit RENEA.
 - Viktimat e dhunës në familje.
 - Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit.
 - Anëtarët e komunitetit egjiptian.
 - Të miturit në konflikt me ligjin, pa ekzekutim të dënimt.
 - Vajzat nëna.
 - Individët nga komuniteti i lesbikeve, gay, biseksualëve dhe transgjiorëve (LGBT).



NJOFTIM I ALBTELECOM SH.A.

ALBtelecom njofton të gjithë pajtimtarët e tij të telefonisë fikse se paketat për pajtimtarët Individual +Fiks (1.499, 1.999, Super 30) dhe ALBtv (Small, Small Fileshare, Medium, Medium Familjare, Large, Large Familjare, Extra Large, Extra Large Premium, Super 100, Super 100 Premium), si edhe paketat për pajtimtarët Biznes +Fiks (Large, Extra Large), Biznes ALBtv (Large, Extra Large), pas datës 11 dhjetor 2017 nuk do të jenë më të vlefshme për aktivizime të reja. Të gjithë ata pajtimtarë, të cilët deri në këtë datë, kanë lidhur ose lidhin kontratë për këto paketa, nuk do të preken nga ky ndryshim, sipas kushteve dhe afatëve të përcaktuara në kontratat përkatëse. Tashmë, për të gjithë pajtimtarët Individual dhe Biznes, të cilët duan të lidhin një kontratë të re ose të rinovojnë kontratën ekzistuese në shërbimet fikse, ALBtelecom ofron paketat SUPERMIKS, për të kombinuar të 3 shërbimet: IPTV, Internet dhe Telefoni Fiks, me çmimë dhe vëllime shumë të favorshme.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 06.12.2017 në orën 16:00 në zyrën e përbaruesit gjyqësor për Irista Tereziu PF
Me adresë në : Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhje, njesia Tregtare nr. 10 Tirane, zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë se paluajtshme të llojit " Njesi " me sipërfaqe totale 87.2 m2 ,numer pasurie, 15/231 -N1, ,vol.2014 -2016, ne zonen kadastrale 8551 me adrese Kavaje. Cnimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 5.830.687.52 (pese milion e teqendin e tridhete mije e gjashteqind e tetedhete e shtate oikje pesedhete e dy Lek)

MINISTRIA E DREJTESISE DREJTORIA E PERGJITHSHME E PERMBARIMIT ZYRA PERMBARIMORE TIRANE

Zyra e Permbarit Tirane me perbarues gjyqësor Albert Fejzo, ne baze te vendimit nr. 10484, date 30.11.2017, shpall shijen ne ankand te pasurise apartamentin te banimit me sipërfaqe 57 m2 te ndodhur ne Rrugën: "Irfan Tomini", pallati 10/2/60 ne Zonen kadastrale 8260 te regjistruar Zyra Vendore Regjistrimit Pasurise Paluajtshme Tirane me nr pasurie nr 2/54-4-60, volumi 6, faqe 82 Tirane , ne vleren duke filluar nga 2.800.000 (dy milion e teqendin mije) Lek.

Ankandi zhvillohet me ambjentet e Zyrës te Permbarit Tirane, ne adresen : Sheshi Mustafa Ataturk , Kryeqezimi " 21 Dhjetori", Tirane dite e Premte , me date 15.12.2017 , ora 16.00.

ANGAZHIMI INTERVISTA

Fëmija që nuk harroi kurrë vargun e "Skodave" me rimorkio drejt vendit të internimit

Ish-të përndjekurit, Hoxha: Pse nuk duhet të fajësojmë PD-në

"Nëse kthejmë kokën pas, s'mund të jemi të përcarë"

Valentina Madani

Flamur Hoxha ka lidhje të forta me PD-në. Përgjatë 27 viteve të pluralizmit politik, ai nuk ndaloj në asnjë 'stacion' tjetër, përveçse qëndroi në shtëpinë e demokracisë. Më 25 qershor kandidoi në Tiranë, edhe pse u rendit në një vend jofitues. Ky moment e angazhoi në mënyrë aktive në PD, duke u bërë pjesë e grupeve të punës në kryeqytet, që po merren me analizën e humbjes së zgjedhjeve. Hoxha tregon për "Gazeta Shqiptare" arsyet e forta që e lidhin me djathtën, pasi diktatura komuniste i pushkatoi gjyshin dhe e persekutoi atë dhe familjen në moshë fare të re. Fëmijë nuk harron kurrë vargun e "Skodave" me rimorkio drejt vendit të internimit, së bashku me shuarjen e ëndrrave dhe fillimin e vuajtjeve për shumë gjenerata. Por pavarësisht vuajtjeve, ai nuk urrit me urrejtjen edhe pse brenda tij "është jeta e shumë brezave që nuk harrohet lehtë". Ndaj, sipërmarrësi Flamur Hoxha e sheh politikën si interes qytetar, edhe pse nuk e fsheh faktin se nganjëherë ajo të cenon. Por, z.Hoxha thotë se mashtrimi është bërë mënyrë jetese, por ai synon të ngrihet kundër mashtrimit aq sa mundet, sepse guxon të jetë në politikë me vetveten dhe të provon se në politikë ka njerëz që nuk u fshihen qytetarëve të tyre.

Z.Hoxha, ju jeni anëtar i PD-së që prej 27 vitesh, por 6 muajt e fundit ju kemi parë më aktiv në politikë. Kam parasysh këtu që ishit kandidat për deputet në listën e Tiranës, ndërsa tani jeni pjesë e grupeve në Tiranë për analizën e humbjes së 25 qershorit. Cili është interesi juaj për politikën, konkretisht PD-në?

Mendoj se kam lindur me Partinë Demokratike, jam anëtar i saj që në dhjetor 1990-ës, kur isha 20 vjeç dhe



Flamur Hoxha, ish-kandidati për deputet i PD-së në Tiranë

nuk i jam larguar asnjëherë PD, nuk kam "pushuar" në asnjë stacion tjetër politik gjatë këtyre tri dekadave. Aktiv kam qenë gjithmonë dhe nuk e kam mohuar që nga themelimi i PD dhe që nga zgjedhjet e këtij viti jam më aktiv, duke iu përgjigjur ftesës së liderit të PD-së, zotit Lulzim Basha për të qenë pjesë e skuadrës së tij politike. Pas një fushate zgjedhore model, të prekshme, të ndershme, të ndershme, të hapur në Bashkinë Kamëz, në qershorin 2017, ku pashë dhe preka me dorë njerëzit, varfërinë e tyre, skamjen, mjerimin, lincimin, lënien mënjane të shumë njerëzve si njerëz të një bote tjetër. Gjej rastin të falënderoj për zemërsisht strukturat, anëtarët, simpatizantët, votuesit dhe çdo derë që m'u hap gjatë fushatës, ku Partia Demokratike doli fituese përballë kundërshtarëve tanë politikë. Prej disa javësh, jam i deleguar nga PD nën 3 degë të saj në Qarkun e Tiranës e konkretisht në degën 11, në Laprakë, në degën 13 në Kashar dhe në degën e Vorës. Jam i përkush-

tuar të përkrahim e dëgjojmë zërin dhe eksperiencat e demokratëve të vërtetë për një proces analize, konsultimesh dhe ringritjeje të PD, si forca e vetme që përfaqëson vlerat e moralin e shqiptarëve në shekuj. Besoj te demokracinë e vërtetë, që nuk e braktisen kurrë PD-së, si e vetmja mënyrë për ta ringritur atë. Në këto zgjedhje të manipuluar, ku ne morëm gjysmë milionë vota demokratësh e qëndrestarësh stoikë, me më shumë vëmendje dhe me më pak arrogancë, besoj te fitorja e PD si forcë e vetme për të ardhmen e fëmijëve tanë në Shqipëri. Interesi im për politikën dhe për Partinë Demokratike është interes qytetar, interes i një qytetari të angazhuar, i një biznesmeni të suksesshëm, që nuk ka përfituar asnjëherë fonde publike qeveritare, që investon këtu në vend dhe që beson fort se demokracia do të thotë pjesëmarrje. Mashtrimi është bërë mënyrë jetese. Unë synoj të ngrihem kundër mashtrimit aq sa mundem. Unë guxoj të jem në politikë me vetveten dhe

PERSEKUTIMI

"Jam nip i një gjyshi të pushkuar jo në fillimet e diktaturës kur ajo selektoi dhe zhdukoi bijtë e vet për të hedhur themelet e saj, por në vitin 1974, kur ishte kulmi i luftës së klasave. Fëmijë që nuk harron kurrë vargun e 'Skodave' me rimorkio drejt vendit të internimit, së bashku me shuarjen e ëndrrave dhe fillimin e vuajtjeve për shumë gjenerata", shpreh z.Hoxha.



Flamur Hoxha me kreun e opozitës, Lulzim Basha

të provoj se në politikë ka njerëz që nuk u fshihen qytetarëve të tyre. Guxoj të jem në politikë për tua provuar qytetarëve që dinë dhe shohin gjithçka, pavarësisht a flasin apo jo, se politika është edhe pasion; se politika ka moral dhe politika nuk duhet të jetë biznes. Unë nuk jam e nuk rri në politikë për këtë gjë, e kam sipërmarrjen time dhe politika vetëm ndoshta ma cenon.

Çfarë ju lidh konkretisht me PD-në dhe sa e keni mbështetur atë, duke marrë parasysh se ju jeni një biznesmen i suksesshëm?

Me Partinë Demokratike më lidh ëndrra për një Shqipëri demokratike, për një atdhe si të gjitha vendet më të zhvilluara të Europës. E thashë, isha i ri kur u bashkova PD dhe shpresa për një politikë e sistemit të ri politik më çoi tek aty. Me Partinë Demokratike më lidh ekonomia e tregut të lirë, që e njoh që në vitin 1993. Për orë të tëra mund të flas për politikën ekonomike të PD-së dhe për reformat ekonomike të saj, pasi kam qenë gjithmonë pjesë aktive në hartimin e diskutimit e këtyre politikave ekonomike të vendit. Kam provuar në ato fillime refugjatit, pastaj pasi mësova në Perëndim, u bera pjesë e sipërmarrjes së modelit evropian, pa përfituar kurrë fonde publike sh-

Fajësimi



ISH-TË PËRNDJEKURIT

"Në një vend të vogël, pas një diktature shumë të egër, është e thjeshtë të kritikosh apo fajësosh partitë apo individët. Si pjesë e tyre, mendoj se vetë ne kemi po aq faj sa ato për çfarë nuk është arritur të bëhet mirë për shtresën tonë. Nëse do ta kthenim shpesh kokën mbrapa, do ta kuptonim se duhej të ishim më të bashkuar se të përcarë", u shpreh z.Hoxha.

tetërore. Modelet më të suksesshme kanë qenë modelet dhe politikat zhvillimore të PD-së dhe jam i bindur se vetëm programet ekonomike të saj, që ishin e janë konkrete ngjallin shpresë, besim e optimizëm tek njerëzit, tek shqiptarët evropianë. Çdo shqiptar e ka provuar në kurriz dhe mund të flasë më shumë se unë për modelin e dështuar të qeverisjes në vitet e fundit, ku të gjithë ëndërrojnë emigrimin si zgjidhje e vetme. Përballen me varfërinë dhe papunësinë, taksat dhe politikën klienteliste, dhunen dhe pabarazinë përballë ligjit, troç me humbjen e shpresës për një të ardhme në vendin tënd.

Kam besuar dhe besoj fort se i vetmi çelës suksesi është ndershmeria. Unë besoj të

Zoti, të mirësia, të djersa e ndershme. Kontribuoj që të jemi sa më shumë njerëz të suksesshëm dhe kështu, e gjithë shoqëria jonë do të jetë më e mirë. Duke pasur qindra të punësuar në këto rreth tri dekada që bëj biznes, punësime të qëndrueshme, kam qenë e jam pjesë e familjes sonë të madhe sociale, duke jetuar me hallat e problemet e familjes sonë të madhe shqiptare.

Ju vini nga shtrësa e ish-të persekutuarve politikë. Jeni rritur në internim. Për cilat arsye?

Unë rrjedh nga një familje mbi të cilën politika dhe diktatura qëllon me rrufe. Të gjithë në një mënyrë a një tjetër i ka ndëshkuar politika gjatë diktaturës, por familjen time e ka pushkuar. Unë jam



Ish-kandidati për deputet: Nuk kam kohë të urrej, ndryshe nxij veten time

Flamur Hoxha: Lidhjet me PD dhe ambicia ime politike

"Shtëpinë ta ndërtojme vetë, s'mund të presim nga të tjerët"

ANGAZHIMI

"Aspiroj të jem në politikë për idealizëm. Synoj apo më saktë pranoj të jem në politikë, nëse pranojmë e nëse votohem pa u përgjyruar e poshtëruar para askujt. Unë thjesht përbush politikisht veten duke shërbyer në politikë", shprehet ish-kandidati për deputet i PD.



Flamur Hoxha gjatë fushatës elektorale

kuar se të përcarë. Unë nuk kam kohë të urrej se kam punë, shumë punë dhe nuk fitoj ndonjë gjë nëse urrej, përveçse nxij jetën time. A duhet të bënte më shumë e djathta për të përndjekurit, më pyesni ju? Përdërisa sot pas gati 30 vitesh kritikojmë dhe kemi akoma shumë për të bërë, pyetja juaj e ka përgjigjen brenda. Partia Demokratike mendoj unë është e vetmja forcë politike që ndjen dhe përfaqëson më së miri këtë shtresë. Nuk e kam parë as ëndërruar kurrë Partinë Demokratike si forcë politike hakmarrëse, por e kam parë si forcë politike që ka në shpirt e në zemër të saj njeriun, lirinë e të drejtat e tij. Partinë Demokratike e kam konsideruar gjithmonë si parti për të gjithë njerëzit e lirë, për njerëzit e lirë edhe prej vetes së tyre, për njerëzit që e kanë vrrarë frikën e tyre, për njerëzit që nuk jetojnë në të kaluarën, por dhe që nuk e harrojnë të kaluarën. Nuk e shoh Partinë Demokratike si forcë politike vetëm e të përndjekurve politikë. Gjithë shqiptarët në diktaturën komuniste kanë qenë në burg ose në kamp përqendrimi, gjithashtu edhe një fshatar komunist në një zonë të humbur në diktaturë jetonte diktaturë varfërie, diktaturë frike.

Cilat janë ambiciet tuaja në politikë dhe a do t'ju shohim deputet herën tjetër?
Ambiciet e mia në politikë janë për të parë në përfaqësim, në sakrificë, në

nder, njerëz më të mirë se vetja. Gjithashtu mendoj e besoj fort se nuk duhet vetëm të kërkojmë që të tjerët apo dikush tjetër të na e ndërtojë shtëpinë pa marrë pjesë vetë ne në ndërtimin e saj, por vetëm duke kritikuar, duke qortuar e duke mos sakrifikuar asgjë nga vetja jonë. Unë aspiroj të jem në politikë për idealizëm. Synoj apo më saktë pranoj të jem në politikë, nëse pranojmë e nëse votohem pa u përgjyruar e poshtëruar para askujt. Unë thjesht përbush politikisht veten duke shërbyer në poli-

tikë. Në emër të një familjeje të madhe dikur, por që dënimi me pushkatim prej komunizmit të mos mund të jetojë si mallkim i përjetshëm linçimi e përjashtimi për mua, familjen e rrethin tim. Më pyesni se a do të jem deputet? Unë siguroj se gjithnjë do të jem Flamur Hoxha, derë e hapur për të gjithë, mik i miqve dhe gjithë njerëzve, pjesë e përgjithshme e Partisë Demokratike. Nuk mendoj se është kusht apo masë për përfshirje të qenit deputet. Unë u përkas atyre njerëzve që e çmojnë njeriun për nderin e dinji-

tetin e tij më shumë se për çdo gjë tjetër, më shumë se për çdo titull apo gradë. Nuk i përkas modës si shumë të tjerë që marrin patentën e të gjitha niveleve e pastaj mësojnë makinën. Besoj dhe jam i bindur se të qenit përfaqësues politik duhet të vijë e të burojë natyrshëm dhe jo artificialisht. Politika, mendoj unë, duhet të jetë vendi i njerëzve që meritojnë atë, i njerëzve që pranojnë të ofrojnë atë që kanë akumuluar dhe trashëguar në jetë, suksesin, përvojën, sakrificën, modestinë, përueljen, moralin.

Diktatura

INTERNIMI

Flamur Hoxha është rritur në internim në rrethinat e Ishmit të Durrësit. Ai ishte në klasën e dytë të shkollës fillore kur një natë në vitin 1975 e ngarkojnë në karrocerinë e njëres prej gjashtë "Skodave" dhe e degdisin përfundimisht larg Kukësit, qytetit ku u lind dhe e nisnin në internim.



← nip i një gjyshi të pushkatuar jo në fillimet e diktaturës, kur ajo po selektoi dhe zhdukoi bijtë e vet për të hedhur themelet e saj, por në vitin 1974, kur ishte në kulmin e luftës së klavave. Fëmijë që nuk harron kurrë vargun e "Skodave" me rimorkio drejt vendit të internimit, së bashku me shuarjen e ëndrrave dhe fillimin e vuajtjeve për shumë gjenerata.

Çfarë mbani mend nga ajo kohë e vështirë e internimit kur ju ishte ende fëmijë?

Jam rritur në internim dhe në periferi të largëta, por falë Zotit dhe familjes sime, me mua nuk është rritur urrejtja për askënd. Mbaj mend aq shumë sa nuk besojmë që fëmijët tanë sot do mbajnë mend kaq shumë

sa ne, ndoshta prej burrëritimit të parakohshëm në fëmijërinë time. Me pak fjalë, brenda meje është jeta e shumë brezave, që nuk harrohet lehtë.

Jo rrallë ish-të përndjekurit politikë kanë shprehur kritikë ndaj PD-së për harresën ndaj tyre. A kanë ata të drejtë në pakënaqësitë e shprehura dhe a duhet të bëjë më shumë e djathta për ta?

Në një vend të vogël pas një diktature shumë të egër është e thjeshtë të kritikosh apo fajësosh partitë apo individët. Si pjesë e tyre mendoj se vetë ne kemi po aq faj sa ato për çfarë nuk është arritur të bëhet mirë për shtresën tonë. Nëse do ta kthenim shpesh kokën mbrapa, do ta kuptonim se duhej të ishim më të bash-

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje programesh Software, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 11,400,500 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyesimit prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
IBC: STANALTR
BIBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje programesh Software, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **26 Dhjetor 2017, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Xhaferri, hetimet për pastrim parash dhe abuzim me fondet

Elbasan, prokurores i humbasin tri dosje hetimore të korrupsionit

Dyshime, se fashikujt janë marrë nga punonjës

Tri dosje të rëndësishme të Prokurorisë së Elbasanit kanë rezultuar të humbura. Vetë prokurorja Armanda Xhaferri ka bërë denoncimin në polici, pasi ka konstatuar në një zyrën e saj kishin humbur 3 fashikuj të procedimeve penale. Bëhet fjalë për dy dosje për pastrim parash dhe një për abuzim me fondet e një rruge, materiale të mbërritura nga Njësia Task Forcës për hetimin e korrupsionit. Burime nga policia bënë me dije se konstatimi i mungesës së fashikujve në zyrën e saj është bërë nga vetë prokurorja Xhaferri, katër ditë më parë. Bëhet me dije se nga verifikimet para-prake rezultoi se ngjarja është pasojë e konflikteve të brendshme në institucionin e akuzës në Elbasan. Ndërkohë, një grup hetimor i ngritur enkas për zbardhjen e kësaj ngjarjeje të rëndë ka verifikuar zyrën e prokurores Xhaferri, por nuk ka konstatuar thyerje nga jashtë. "Ka dyshime të forta se fashikujt janë marrë nga punonjës të kësaj prokurorie, pa dënimin e saj", thonë burimet policore. Prokurorja Xhaferri, me firmën e titullarit është transferuar në një seksion tjetër dhe sipas ligjit, duhet të bëjë dorëzimin e dosjeve, që tashmë pretendohet se



janë zhdukur. Zhdukja e fashikujve mbetet ende e paqartë, por Xhaferri ka pretenduar para hetuesve se bëhet fjalë për dosjet tejet të rëndësishme dhe me impakt të lartë në publik e për këtë arsye, këmbëngul që hetimin e këtyre çështjeve

duhet ta vijojë ajo. Mësohet të ketë qenë pikërisht kjo, arsyeja pse më herët prokurorja ka refuzuar të bëjë dhe dorëzimin e fashikujve, të cilët më pas nuk i ka gjetur në zyrën e saj të punës, por janë marrë prej andej nga administrata e

prokurorisë dhe i janë dorëzuar një tjetër prokurori. Mbetet ende i paqartë konflikti i lindur në institucionin e organit të akuzës në Elbasan dhe përsa u përket emrave të personave që po hetohen për pastrim parash e korrupsion, burimet poli-

DYSHIMET

Një grup hetimor i ngritur enkas për zbardhjen e kësaj ngjarjeje të rëndë ka verifikuar zyrën e prokurores Xhaferri, por nuk ka konstatuar thyerje nga jashtë. "Ka dyshime të forta se fashikujt janë marrë nga punonjës të kësaj prokurorie, pa dënimin e saj", thonë burimet policore.

core janë treguar të rezervuar. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor, Tiranë, për veprimet të mëtejshme dhe po hetohet për veprat penale "Shpërdorim detyrë" dhe "Zhdukja ose humbja e fashikullit".

SHKURT

Kanosi me armë nënën dhe vëllain, arrestohet 25-vjeçari

TIRANE - Një i ri ka rënë në pranga ditën e djeshme, pasi ka kanosur nënën dhe vëllain e tij. Burime zyrtare nga policia e Tiranës bënë me dije se bëhet fjalë për shtetasin Dritan Billa, 25 vjeç, banues në fshatin Zalt, Kashar. Billa rezultoi i dënuar më parë për veprën penale "Plagosje e rëndë me dashje". Uniformat blu njoftojnë se ngjarja ka ndodhur rreth orës 16:30, në fshatin Zalt, në banesë, ku pas një konflikti për motive të dobëta, 25-vjeçari ka kanosur nënën D.B., 61 vjeçe dhe vëllain F.B., 33 vjeç. Ai ka qëlluar në ajër me armën e zjarrit pistoletë, duke prishur rendin e qetësinë dhe më pas është larguar nga banesa me mjetin e tij. Menjëherë nga ana e policisë janë organizuar shërbimet dhe është bërë e mundur që rreth orës 22:45, Dritan Billa të konstatohet në lëvizje në lagjen Shkozë, Tiranë, ku është arrestuar menjëherë.

Kundershtoi me dhunë efektivin e Policisë Rrugore, arrestohet shoferi

LEZHE - Një drejtues automjeti ka rënë në pranga ditën e djeshme, pasi ka kundërshtuar me dhunë efektivin e policisë rrugore të Komisarariatit të Policisë, Lezhë. Ngjarja është regjistruar në hyrje të qytetit të Lezhës rreth orës 12:00, ndërsa në pranga ka përfunduar Sebastjano Malotaj, 22 vjeç. Efektivi i Policisë Rrugore të Lezhës me iniciale N.N. ka ndaluar për shkelje të rregullave të qarkullimit një automjet tip "Mercedes", brenda të cilit ndodheshin 4 persona, të cilët kanë kundërshtuar gjohën e policit. Sipas burimeve në vendngjarje, drejtuesi i mjetit është përplasur edhe fizikisht me efektivin e policisë, i cili ka thirrur menjëherë forcat e rendit për mbështetje.

Dyshimet e policisë: Viktima, përdorues i alkoolit

Gjendet në kanal trupi i pajetë i një 26-vjeçari

bimet policore, ku kanë konstatuar se viktimja është banues në fshatin Barbullush. 26-vjeçari është dërguar në morgun e Spitalit Rajonal Shkodër. Nga këqyrja paraprake mjekoligjore, bëhet me dije se në trupin e viktimës nuk konstatohen shenja dhune apo

të ndonjë faktor tjetër të jashtëm. Forcat policore nga deklarimet e marra në zonën ku jetonte i riu, njoftojnë viktimja nuk ka pasur konflikte të hapura me persona të tjerë, por kishte probleme mendore dhe ishte përdorues alkooli dhe dyshohet se shkak i vdekjes

është mbytja në ujë. Sakaq, pritet ekspertiza e plotë mjeko-ligjore për përcaktimin e shkakut të saktë të vdekjes. Grupi hetimor në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjiqësor Shkodër po punonjë për sqarimin e rrethanave të kësaj ngjarjeje.



SHKODER - Mesditën e djeshme në orën 12:50, në fshatin Barbullush në Shkodër është gjetur nga kalimtarët në një kanal kullues, trupi i pajetë i një të riu. Bëhet fjalë për shtetasin R.B., 26 vjeç. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar shër-

STRATI Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Pyl", me sipërfaqe 6000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/422 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 82, rregjistruar në pronësi të Shoqëria "Gjyzeli-BLB" sh.a, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 15,120,000 Lekë.

"Pyl", me sipërfaqe 1000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/424 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 81, rregjistruar në pronësi të Ylli Braka dhe Ermira Braka, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 2,520,000 Lekë.

"Truall", me sipërfaqe 2497 m², nga e cila 2497 m² truall dhe 161 m² ndërtesë ndodhur në Metalurgji Elbasan, me Nr. 432/3 Pasurie, Zona Kadastrale 3965, volumni 4, faqe 247, rregjistruar në pronësi të Armand Shuipi, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2173 Rep, Nr. 1409/2 Kol, datë 24.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 3,133,065.6 Lekë.

"Arë+Truall", me sipërfaqe 4,500 m², nga e cila 400 m² truall dhe 176 m² ndërtesë, ndodhur në Sallmone, Durrës, me Nr. 178/1 Pasurie, Zona Kadastrale 3255, volumni 6, faqe 135, rregjistruar në pronësi të Bujar Gjyzeli, lënë si garanci hipotekore për Bankën Tirana sh.a me Kontratë Hipoteke Nr. 657 Rep, Nr. 3111/1 Kol., datë 11.08.2014 dhe Kontratë Hipoteke Nr. 1512 Rep, Nr. 1356/3 Kol., datë 23.10.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 9,534,672 Lekë.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.12.2017.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

NJOFTIMI I PERGJITHSHEM PROKURIMI

Shteti: Shqipëri
 Projekti: Projekti i Mikrofinancës në Shqipëri
 Sektori: Mikrofinancë
 Mënyra e financimit: Hua e IDB (ALB 0030), Hua e ISFD (ALB 0031) dhe Granti i Asistencës Teknike (ALB 0032)

Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit FAF Sh.a ka marrë financim në shumën prej 5.30 milion USD, ekuivalent nga Banka Islamike për Zhvillim, në drejtim të kostos së Projektit Mikrofinanciar në Shqipëri dhe ka për qëllim të zbatojë një pjesë të ardhurave për pagesat për mallrat, punimet, shërbimet e lidhura dhe shërbimet e konsulentëve që do të përdoren në kuadër të këtij projekti. Ky projekt do të financohet bashkërisht nga Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit FAF Sh.a.

Projekti do të përfshijë komponentët e mëposhtëm:

- I. Skema e Mikrofinancës
- II. Ngritja e Kapaciteteve dhe Trajnime
- III. Auditimi Financiar
- IV. Vlerësimi i mikrofinancës
- V. Hulimtimi i vlerësimit bazë / afatmesëm / përfundimtar

Prokurimi i kontratave të financuara nga Banka Islamike për Zhvillim do të bëhet përmes procedurave të përcaktuara në Udhëzimet për Prokurimin e Mallrave dhe Punimeve sipas financimit të Bankës Islamike të Zhvillimit (edicioni aktual) dhe është i hapur për të gjithë ofertuesit e kualifikuar siç përcaktohet në udhëzim.

Njoftimet specifike të prokurimit për kontratat do të ofrohen sipas procedurave kombëtare të blerjeve. Parakualifikimi i furnizuesve dhe kontraktorëve do të kërkohet për kontratat e mëposhtme:

- I. Sistemi Qëndror i Bankës "MIS"

Ministri Maiziere: Shfrytëzoni ofertën, ne iu ndihmojmë me ndihma konkrete

Gjermania ofron 3 mijë euro për azilantët që duan të riatdhesohen

"Ja kur është afati i fundit i kërkesës"

Voltiza Duro

Tashmë të gjithë azilantët që dëshirojnë të rikthehen në vendet e tyre mund të përfitojnë ndihmë nga shteti gjerman për t'u integruar sërish në atdhe, përfshirë këtu edhe shqiptarët. Por afati i fundit kur ata mund të bëjnë kërkesën për ndihmë nuk duhet të jetë më larg se 28 shkurti i vitit 2018. Të gjitha familjet që u është refuzuar kërkesa për azil në Gjermani, do të kenë mundësinë të përfitojnë plot 3 mijë euro, ndërsa individët 1 mijë euro. Këto para mund të përdoren për të paguar qiranë, për të riparuar banesën, për pajisjen e tyre me mobilie, pra për të rifilluar një jetë të re. Kjo nisim e shtetit gjerman vjen në kuadër të programit "Vendi yt, e ardhmja jote", që plotëson programin "Starthilfe plus". Gazeta "Bild am Sonntag" bën me dije se nga 115 mijë azilantë të refuzuar, vetëm 8639 prej tyre kanë aplikuar për ndihmë për rikthim në vendin e tyre të origjinës. Ndërkaq, 80 mijë prej tyre kanë statusin "Duldung", 35.000 pritet të dëbohen, ndërkohë që nga muaji janar deri në shtator të vitit



2017 janë dëbuar plot 19.520 vetë nga Gjermania. Më tej, ministri i Brendshëm, Thomas de Maiziere u bën thirrje azilantëve të refuzuar që ta shfrytëzojnë këtë ofertë, e cila vlen deri në fund

të muajit shkurt. "Nëse ju vendosni deri në fund të muajit shkurt që të ktheheni vullnetarisht në vendlindje, mund të përfitoni edhe këtë ndihmë shtesë për shpenzimet për strehim

në vendin tuaj. Ne ju ndihmojmë me ndihma konkrete për riintegrimin", tha ministri gjerman. Nga ky program ndihmes mund të përfitojnë edhe të gjithë ata azilantë shqiptarë apo



kosovarë, të cilëve iu është refuzuar e drejta për të qëndruar në shtetin gjerman, e që dëshirojnë të kthehen sërish në vendlindje. Autoritetet në Gjermani, prej vitësh mundësojnë programe të

ndryshme ndihmuese për të gjithë ata që jetojnë në këtë shtet, por duan të rikthehen sërish në vendet e origjinës, pavarësisht nëse janë azilantë apo kanë një leje qëndrimi.

Erion Veliaj: Qytetarë, jepni kontributin tuaj

Bashkia e Tiranës e vullnetarët shpërndajnë ushqime për familjet në nevojë

Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me vullnetarët kanë vijuar shpërndarjen e ndihmave për familjet e prekura nga përmbytjet e ditëve të fundit. Kryebashkiaku Erion Veliaj ditën e djeshme ndihmoi banorët e zonës së Sharrës në Kombinat me ushqime e veshmbathje dhe falënderoi të gjithë vullnetarët bashkëpunues. "Kemi zgjedhur që të gjithë njerëzve në listën e ndihmës ekonomike t'u çojmë paketa ushqimore, që tekta merren me rregullimin e shtëpisë dhe kujdesin ndaj fëmijëve, të mos shqetësohen për çështjet e ushqimeve dhe veshmbathjeve. Sot jemi duke shpërndarë ndihma në të gjitha zonat periferike të Tiranës, kryesisht zona e Kombinatit, zonat e Bregut të Lumit, zonat e Shkozës, në zonën e Alliasit", - u shpreh Veliaj. Më tej, ai theksoi se vëmendja e Bashkisë së Tiranës në këto ditë është përqendruar kryesisht në zonat rurale, ku ka pasur rrëshqitje dherash apo probleme me transportin dhe shprehu




Kryebashkiaku Erion Veliaj duke shpërndarë ndihmat

mirënjohjen për të gjithë ata që u treguan solidarë në këtë situatë tejet të vështirë. "Dua të falënderoj jo vetëm vullnetarët që kanë qënë në çdo cep të Tiranës, por edhe bujarinë e paimagjueshme të sipërmarrjeve të Tiranës dhe familjeve tiranase", - tha kryebashkiaku. Ky i fundit u ndal edhe të situata e furnizimit me ujë, ku bëri me dije

se impianti i Bovillës ka filluar të funksionojë normalisht, ndërsa u bëri thirrje të gjithë qytetarëve që duan që këto ditë të japin kontributin e tyre, qoftë duke ofruar ndihma materiale apo edhe të ofrojnë ndihmë fizike duke i shpërndarë ato, t'u bashkohen ekipeve të bashkisë dhe rrjetit të vullnetarëve.



This project is funded by the European Union



THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME

Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara po zbatojnë projektin "Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Evropian.

Projekti synon të kontribuojë në fuqizimin e shoqërisë civile, për të marrë pjesë aktivisht dhe të influencojë mirë-funksionimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Fokusi i këtij projekti është të punojë me organizatat e shoqërisë civile të përfshira në monitorimin dhe aksesin në drejtësi, shoqata rinore dhe studentore, iniciativa qytetare, etj, ndër të cilat: 75 organizata që marrin pjesë në aktivitete për rritjen e kapaciteteve të tyre, 34 organizata që përfitojnë grante, dhe 40 organizata që bëhen pjesë e Koalicionit.

Kjo thirrje për Projekt-Propozime, është e vlefshme prej datës **1 nëntor – 15 dhjetor 2017**, dhe i përket Skemës së Granteve, si një nga komponentët kryesorë të projektit, i cili ka si qëllim financimin e projekteve që adresojnë çështjet e forcimit të organizatave të shoqërisë civile për të rritur transparencën dhe besueshmërinë e sistemit të drejtësisë dhe për të përmirësuar aksesin në drejtësi të grupeve të marxhinalizuara në Shqipëri.

Shuma në dispozicion për këtë Thirrje është EUR 435,000.00.

Buxheti i kërkuar për çdo Projekt-Propozim duhet të jetë si më poshtë:

Grante të vogla:	EUR 10,000.00 - 15,000.00	(deri në 12);
Grante të mesme:	EUR 20,000.00 - 25,000.00	(deri në 12).

Afati i fundit i dorëzimit të Projekt-Propozimeve është **15 dhjetor 2017, ora 14:00**.

Udhëzimet për mënyrën e aplikimit dhe dorëzimit të projekt-propozimeve, përshkruhen në Udhëzimin për Aplikim të Granteve, e cila mund të gjendet në internet, në:

<http://albania/savethechildren.net>
<https://cefsajja.wordpress.com>

Një kopje e Udhëzimit të Aplikimit dhe formatit të aplikimit mund të kërkohet edhe duke dërguar një email në:

cefsajja.albania@savethechildren.org
office@qshpli.org

DITA NDERKOMBETARE PREMTIMI

Presidenti, premtim të veçantë ndaj shtresës me aftësi të kufizuara

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara zhvilloi dje një takim me përfaqësues të Shoqatës së Invalidëve Para-Tetraplegjikë dhe të Shoqatës së Verbërve të Shqipërisë. Presidenti Meta bëri një premtim të thjeshtë dhe tepër të veçantë për personat me aftësi ndryshe, se në të gjitha hyrjet në Presidencë do të ketë rampë. Gjithashtu, në cilësinë e presidentit ai do t'u kërkojë institucioneve shtetërore që të ndërtojnë rampë në mënyrë që kjo kategori ta ketë sa më të lehtë hyrjen në këto institucione. "Në këtë takim, Presidenti Meta u garanto mbështetje e dialog të përhershëm dhe u angazhua të nxisë institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile t'ju kushtojnë më tepër vëmendje sfidave për integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Përfaqësuesit e Shoqatës së Invalidëve Para-Tetraplegjikë dhe të Shoqatës së Verbërve të Shqipërisë e njohën presidentin me problematikën e tyre dhe e falënderuan për vëmendjen dhe dialo-

Dita e aftësive ndryshe, Meta: Mbështetje e dialog të përhershëm

"Vëmendje, sfidave për integrimin e plotë në shoqëri"



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, në takim me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara

gun", thuhet në njoftimin e presidencës. Mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara mbetet një çështje

që kërkon vëmendje të veçantë. Ekziston një kuadër ligjor që sanksionon këtë të drejtë, por zbatimi i tij mbetet domosdoshmëri dhe ndërgjegjësi i të gjithë aktorëve për të drejtat e këtij komuniteti. Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë diskriminimin kundër personave me aftësi të kufizuara fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore në punësim, arsim, shëndetësi dhe shërbime të tjera shtetërore. Megjithatë, punonjësit, shkollat dhe personeli shëndetësor dhe punonjësit të shërbimeve të tjera shëndetësore ndonjëherë diskriminojnë këto persona. Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me personat e cenushtëm nga ana

sociale dhe/ose me aftësi të kufizuara, që është pjesë e prioritetit kyç për mosdiskriminimin. Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me vështirësi në aksesin e arsimit, punësimin, kujdesit shëndetësor dhe shërbimet sociale. Megjithëse në vitet e fundit kuadri ligjor dhe ndjeshmëria e shoqërisë ndaj personave me aftësi të kufizuara është përmirësuar, kjo kategori është në një pozitë më inferiore se pjesa tjetër e shoqërisë. Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë kundrejt personave me aftësi

PREMTIMI
Presidenti Meta u garanto përfaqësuesve të Shoqatës së Invalidëve Para-Tetraplegjikë dhe të Shoqatës së Verbërve të Shqipërisë mbështetje e dialog të përhershëm dhe u angazhua të nxisë institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile t'ju kushtojnë më tepër vëmendje sfidave për integrimin e tyre të plotë në shoqëri.

të kufizuara ekziston në të gjitha aspektet e jetës sociale dhe private dhe është më i theksuar në punësim, arsim, aksesin në ndërtesa dhe shërbime si dhe në jetën e pavarur. Pozita e personave me aftësi të kufizuara mund të vëzhgohet më mirë, duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë, nivelin e ulët të arsimit, varfërinë, përfaqësimin e ulët në jetën politike, riskun e institucionalizimit, si dhe mungesën e përshatjes për këtë kategori, e cila sjell vështirësi kryesisht në aksesin në shërbime dhe ndërtesa.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJII I POSAÇEM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organike dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posaçëm të Apelit":

I - Shpall vendet vakante për pozicionet:

1. **Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Mardhënieve me Median dhe Publikun**
Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Drejtësi.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

2. **Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse**

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
 - b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

3. **Specialist Sekretarie Gjyqësore**

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
 - b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

4. **Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve**

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë në Drejtësi.
 - b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

5. **Përkthyes**

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip - Anglisht - Shqip.
 - b. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
 - c. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombetare.

6. **Koordinator për mediat dhe mardhënie me jashtë**

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë në Drejtësi.
 - b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e mardhënieve me median/ mardhënie me jashtë.

7. **Specialist për prirjen me popullin**

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë në Drejtësi.
 - b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

II - Rishpall vendet vakante për pozicionet:

8. **Specialist Financë/Buxhet**

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
 - b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
 - d. Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

9. **Specialist i Burimeve Njerëzore**

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
 - b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

10. **Specialist IT**

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
 - b. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
 - c. Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
 - d. Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
 - e. Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve ëeb (Eordpress, Drupal, Joomla etj).
 - f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

11. **Specialist Protokoll/Arkive**

- Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:
- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
 - b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze
 - c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për të pajisur me Certificate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për të përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 11 Dhjetor deri më 15 Dhjetor 2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 15 Dhjetor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 11 Dhjetor deri më 15 Dhjetor 2017 në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterzuar. Diplomën që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Epuror Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.



FAKTORET QE NDIKOJNE



Ylli Merja: Kurat popullore, si të ulni kolesterolin brenda një muaji

SI TRANSMETOHET SEMUNDJA E SHEKULLIT



ISHP: Cilat janë mënyrat për parandalimin e HIV/AIDS

Monika Fida:



◆ Dermatologia:
Ja cilët janë faktorët ndikues të brendshëm e të jashtëm

Sekreti për një lëkurë 20 vite më të re, si të eliminoni rrudhat

"Kujdesi duhet të fillojë në moshë të re"

• Këshilla të vlefshme për t'u mbrojtur nga situatat e përmbytjeve

Dermatologia: Ja cilët janë faktorët ndikues të brendshëm e të jashtëm

Monika Fida:

Sekreti për një lëkurë 20 vite më të re, si të eliminoni rrudhat

"Kujdesi duhet të fillojë në moshë të re"

Voltiza Duro

Plakja e lëkurës dhe rrudhat janë ndër shenjat që vitet lënë pas, proces ky i pashmangshëm, por që ndikohet edhe nga një sërë faktorësh të jashtëm. Ekspozimi gjatë nën rrezet e diellit, pirja e duhanit dhe alkoolit, por edhe prekja nga pluhuri përshpejtojnë procesin e plakjes së lëkurës dhe krijimin e rrudhave, aq të padëshiruara, veçanërisht nga femrat. Në një intervistë ekskluzive për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", dermatologia Monika Fida, doktoreshë e Shkencave Mjekësore, njëkohësisht pedagog në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë tregon një sërë faktorësh të brendshëm e të jashtëm që ndikojnë në plakjen e lëkurës. Sipas saj, kujdesi duhet të fillojë që në moshë të re dhe më tej zbulon sekretin e një lëkure të shëndetshme, që iu tregon 20 vite më të re.

Cilat janë disa nga ndryshimet që pëson lëkura me kalimin e viteve?

Komponentët e lëkurës ndryshojnë me moshën. Një karakteristikë është që lëkura e personave të rinj përmban më shumë qeliza yndyrore se lëkura e personave në moshë më të madhe. Kjo është një arsye pse lëkura e plakur duket më transparente dhe më e hollë se lëkura e moshave të reja. Gjithashtu, mbajtja e ujit në lëkurë dhe përbërja e lëkurës si keramidet, acidit hialuronik, polisaharidet, glicerina etj., ndryshojnë me moshën.

A bëhet më delikate lëkura në moshat e mëdha?

Lëkura e plakur është gjithashtu më e ndjeshme ndaj reaksioneve alergjike, më sensitive dhe irritohet më

“Plakja e lëkurës dhe krijimi i rrudhave është një proces fiziologjik shumë i komplikuar, ku ndikojnë një sërë faktorësh. Në faktorët e jashtëm mund të përmendim dëmtimin nga dielli, pluhurin, dëmtimin nga radikalet e lira, pirjen e duhanit dhe alkoolin, ndryshimet e temperaturave etj.”

shpejt se sa lëkura e re dhe kjo si rezultat i dobësisë së sistemit imun. Por vlen të theksoj se lëkura e thatë nuk do të thotë që është një lëkurë me rrudha. Në pamje të parë lëkura e thatë mund të duket më e rrudhur, por jo që ka shenjë barazimi ndërmjet këtyre të dy-

ndryshimet e temperaturave etj. Ndërsa faktorët e brendshëm që ndikojnë në plakjen e lëkurës janë predispozita gjenetike, plakja kronologjike fiziologjike, mungesa hormonale, problemet e sistemit imun. Tërë këta faktorë si të brendshëm dhe të jashtëm



Dermatologia Monika Fida

Është fakt që hidratimi i lëkurës me kremra nuk ka efekt shumë të gjatë në parandalimin e rrudhave.

Si mund të parandalohet plakja e lëkurës?

Nëse qëllimi juaj është që të keni një lëkurë sa më të shëndetshme dhe të dukeni në një moshë 30-vjeçare edhe kur ju jeni 50, atëherë duhet t'u përmbaheni planeve ekzakta, duke luftuar fort agjentët e jashtëm dëmtues të lëkurës. Këto plane dhe skema trajtimi të shtrira në

vijezimeve të lehta rreth syve dhe rreth buzëve është shumë shqetësuese për ju, atëherë është koha për të marrë në konsideratë përdorimin e acidit hialuronik, të ndonjë produkti fillers tjetër ose toksinës së botulinës (Botoks). Procedura të tjera për mirëmbajtje të lëkurës që aplikohen shumë në këtë grupmoshë dhe që realizojnë përmirësim të dukshëm janë: Mesoterapia, PRP injeksione plazme, lazer i fraksionuar, radiofrekuenca, dermaroller. Gjithsesi, këto procedura duhet të aplikohen vetëm nga mjekë dermatologë ose kirurgë plastikë të kualifikuar dhe me eksperiencë në këtë fushë.

Kur duhet të fillojë kujdesi ndaj lëkurës?

Pavarësisht se cilës moshe i përkisni, regjimi juaj duhet të përmbajë mbrojtje ndaj diellit si dhe të pini sa më shumë ujë gjatë ditës, në mënyrë që të hidratoni lëkurën tuaj dhe të largoni toksinat nga organizmi. Procedura e kombinuara realizojnë një përmirësim të lëkurës tuaj. Frekuentoni mjekun dermatolog për të realizuar planin tuaj të personalizuar, për të kryer procedurën në luftën kundër rrudhave. Edhe me një buxhet të vogël, ju mund të kryeni diçka duke frenuar kohën e duke mirëmbajtur lëkurën tuaj.

Cilat janë disa nga rekomandimet tuaja në luftën kundër rrudhave?

Kujdesi më i rëndësishëm për lëkurën, pavarësisht se në ç'moshë jeni është të përdorni krem mbrojtës kundra diellit qdo ditë, pavarësisht moshës. Duke përdorur kremin me faktor mbrojtës kundra diellit gjatë gjithë jetës, jo vetëm që parandaloni shenjat e plakjes së lëkurës, por gjithashtu ju mbron nga zhvillimi i kancerit të lëkurës më vonë.

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË PLAKJEN E LËKURËS:

Faktorët të kontrollueshëm	Faktorët të pakontrollueshëm
Alkooli	Plakja fiziologjike
Pirja e duhanit	Sëmundje të ndryshme, veçanërisht endokrinologjike
Dietat e rënda	Shprehja e fytyrës, mimika
Dehidrimi	Gjinia
Dieta e njëanshme	Gjenetika (grupi etnik, lëmueshmëria dhe ndërtimi i lëkurës dhe fibrave elastinës e kolagenit.)
Stërvtija dhe ushtrimet periodike të forcuara	Hormonet
Produktet e lëkurës dëmtuese	Plagosjet dhe dëmtimet e ndryshme
Ndotja dhe pluhuri	Reaksione të fotosensibilitetit.
Gjumi	
Stresi	
Rrezatimi diellor	

jave. Pra, formimi i rrudhës është një proces kompleks dhe nuk varet nga lloji i lëkurës që personi ka.

Cilët janë disa nga faktorët që ndikojnë në krijimin e rrudhave?

Plakja e lëkurës dhe krijimi i rrudhave është një proces fiziologjik shumë i komplikuar, ku ndikojnë një sërë faktorësh. Në faktorët e jashtëm mund të përmendim dëmtimin nga dielli, pluhurin, dëmtimin nga radikalet e lira, pirjen e duhanit dhe alkoolin,

veprojnë duke paraqitur kështu lëkurën më të plakur dhe me rrudha.


Sa ndihmojnë kremrat hidratues në eliminimin e tyre?

Një person me lëkurë të yndyrshme ka vetinë që të realizojë vetë deri diku zbutjen e saj apo hidratimin, pra përmban përbërës yndyrorë ose ujë, gjë e cila ndihmon që lëkura të duket më e lëmuar dhe e hidratuar edhe pa ndihmën e një kremi hidratues.

kohë planifikohen nga mjeku juaj dermatolog në bashkëpunim me ju. Është pikërisht kjo që duhet të bëni, të ndërtoni një strategji dhe plan për të parandaluar plakjen e lëkurës. Sot ekzistojnë dhe përdoren gjerësisht një sërë procedurash që mund t'ju ndihmojnë në lidhje me këtë.

Cilat janë disa nga këto procedura që mund të aplikohen për minimizimin e rrudhave?

Nëse paraqitja e rrudhave dhe



Dy tipat e kolesterolit janë ato, që nëse nuk i ruajmë brenda vlerave, atëherë bëhen shkak për lindjen e sëmundjeve të ndryshme si hipertensioni aritmia, problemet në veshka, pagjumësia etj. Kolesterolit LDL i quajtur kolesterol i keq është lipoprotein me densitet të ulët. Këto lipoproteina shpeshherë depozitohen në muret e brendshme të arterieve, duke ngushtuar diametrimin e tyre. Ndërsa kolesterolit HDL i njohur si kolesterol i mirë është lipoprotein me densitet të lartë. Këto grimca pastrojnë enët e qarkullimit të gjakut nga LDL dhe kur ato rriten shumë mbi vlerat e depozitojnë LDL në mëlçi. Kur LDL, HDL dhe VLDL kalojnë mbi vlerat 280 mg/dco 300mg/dcl 400mg/dhe atëherë shfaqen shqetësimet në zemër. Në rast se personi nuk fillon të tregojë kujdes për të ulur kolesterolin, atëherë fillon procesi i përgjithësuar, që gradualisht dhe në mënyrë të vazhdueshme arteriet të fillojnë të mbushen vende-vende nga brenda me këto pllakëza dhjamore. Në përgjithësi ky proces fillon të ndihet pas moshës 40-45 vjeç.

Faktorët që rrisin kolesterolin në gjak

Disa prej faktorëve që ndikojnë në rritjen e kolesterolit në gjak janë: jeta e qetë, qëndrimi sedentar, obeziteti, dieta e pasëndeshme, duhanpirja, diabeti.

Shenjat e para

Vërehet një fryrje e gishtave të dorës, shpeshherë personi fillon të ndiejë dhimbje koke, mund të ketë dhimbje në kraharor, ndonjëherë mund të ketë një goditje në zemër ose shtrëngim të saj. Gjithashtu, mund të ndiejë dhimbje të kyçeve të këmbëve, "ndeze" të tyre. Personi në mëngjes kur cohet nga gjumi fillon të ketë shenja të harrësës. Tek disa persona mund të shfaqet ankth, marrje mendsh, lodhje e shpejtë dhe vështirësi në frymëmarrje. Por, si duhet të veprojmi për të mbajtur brenda vlerave 2 treguesit kryesorë të kolesterolit në gjak?

Në rast se LDL fillon të rritet mbi 150-180mg/dcl-210mg/dcl atëherë këto lipoproteina fillojnë t'u ngjiten arterieve nga brenda dhe vende-vende fillon sklerotizimi i arterieve e kundërta ndodh me HDL. Kur ky fillon të ulet më poshtë se 35mg/dcl, atëherë pakësohet mundësia e pastrimit të LDL. Pra, siç e shohim, kryesorë është që të mbajmë HDL më shumë se 35mg/dcl dhe trigliceridet fillojnë të rriten mbi 150 mg/dcl.

Masat parandaluese

Ushtrimet fizike janë ndër të parat që fillojnë të luftojnë arteriosklerozën. Një vrap 5-10 minuta nxit shumë qarkullimin e gjakut dhe ndihmon në shkëputjen e këtyre grimcave nga vendi ku janë ngjitur. Konsumimi i ushqimeve me pak kripë dhe pakësimi i ushqimeve të skuqura bën që të mos rritet tensioni dhe mëlçia të punojë me shumë për depozitimin e LDL. Konsumimi i produkteve shtazore pakëson mundësinë e

Mjeku: Faktorët që ndikojnë në tejkalimin e parametrave normalë, shenjat e para

Ylli Merja: Kurat popullore, si të ulni kolesterolin brenda një muaji

"Trajtimi me lulen e murrizit e shtogut"




Mjeku Ylli Merja

shtimit të kolesterolit, ndërkohë që ne i kemi shpallur luftë të heshur atij. Përdorimi i mishit të peshkut, në veçanti salmonit, bën që omega acidet yndyrore të pangopura të ndikojnë në uljen e kolesterolit total. Ushqimet me fibra që përmbajnë Beta Glukan largojnë toksinat nga organizmi dhe largojnë LDL. Konsumimi i ushqimeve që përmbajnë

Gluteinë një antioksidant me ngjyrë të verdhë që gjendet tek spinaqi, veza, aloe vlera ndikojnë në humbje të LDL-së dhe triglicerideve. Konsumimi i frutave të thata si arra 4-6 kokrra në ditë, bajame 6-8 kokrra në ditë ose edhe lajtini ndikon në rritjen e HDL. Konsumimi i bishtajoreve si fasulet, bizelja thirrja etj., duke

Ushtrimet fizike janë ndër të parat që fillojnë të luftojnë arteriosklerozën. Një vrap 5-10 minuta nxit shumë qarkullimin e gjakut dhe ndihmon në shkëputjen e këtyre grimcave nga vendi ku janë ngjitur.



konsumimi i 2-3 frutave të stinës në ditë ndikon në largimin e LDL. Përdorimi i uthullës së mollës së egër në dozën 1-2 lugë gjelle në ditë ul nivelin e triglicerideve dhe rrijëdhimisht ul kolesterolin VLDL.

Kurat popullore

Krahas ushqimeve të përditshme që përmbajnë antioksidantë, vitaminën B, fibra të shumta; një ndihmë shumë e mirë për të ulur kolesterolin brenda një periudhe 1-mujore japim bimët mjekësore. Ja cilat nga bimët mund t'i përdorni që brenda një muaji kolesterolin ta ulin 50-70mg/dcl. Të gjitha bimët që përmbajnë acide organike ulin kolesterolin në gjak. Lulja dhe fruti i murrizit përmban acidin triterpenik, molla e egër përmban acidin malik në përqindje të lartë, kafja pa kafeinë dhe fruti i shtogut përmbajnë acidin klorogjenik, që ndikon në shkrirjen e dhjamtit në organizëm. Gjemb i gomarit, angjinaria, çikorja rregullojnë metabolizmin e përmirësojnë punën e mëlçisë. Bimë që përmbajnë betastosterole dhe sitostanole, si majdanozi dhe kanella ndikojnë në tretje dhe pastrojnë enët e qarkullimit të gjakut.

Vaji i lirit me dozat 5-10 ml në ditë ndihmon tretjen dhe jash-tëqitjen, njëkohësisht ndikon në largimin e LDL nga organizmi. Si përfundim, nëse kolesterolit të keq me vlerat mbi 220mg/dcl i shpallim një luftë të heshur për rreth një muaj, atëherë ju dilni fitimtarë mbi arteriosklerozën.

Si transmetohet sëmundja e shekullit, ja shenjat e para dhe trajtimi

ISHP: Cilat janë mënyrat për parandalimin e HIV/AIDS

"Kategoritë më të predispozuara"

Në ditën ndërko mbëtare në luftën kundër HIV/AIDS, Instituti i Shëndetit Publik bën thirrje për më tepër sensibilizim dhe thekson masat parandaluese për të mos u prekur nga kjo sëmundje vdekjeprurëse. HIV vazhdon të mbetet një problem i madh i shëndetit publik në nivel global, duke marrë më shumë se 35 milionë jetë njerëzish deri tani. Në fund të vitit 2016, globalisht pati përafërsisht 36.7 milionë njerëz që jetonin me HIV, ku 1.8 milionë prej tyre u infektuan vetëm në vitin 2016. 54% e të rriturve dhe 43% e fëmijëve që jetojnë aktualisht me HIV marrin terapinë gjithëpërfshirëse antiretrovirale (ART).

Infeksioni HIV shpesh diagnostikohet nëpërmjet testeve të shpejta diagnostike, që zbulojnë praninë ose mungesën e antitropave HIV. Shumica e këtyre testeve japin rezultate brenda ditës, gjë që është thelbësore për vendosjen e diagnozës në të njëjtën ditë, si dhe për trajtimin dhe kujdesin e hershëm.

Cfarë është HIV

HIV (Virusi i Imunodeficiencës Njerëzore) është virusi i cili prek dhe dobëson sistemin imunitar të organizmit të njeriut, duke e lënë atë të pambrojtur nga infeksionet dhe nga disa lloje kanceri. Shkatërrimi dhe dëmtimi gradual i funksionit të qelizave të imunitetit i bën gradualisht individët e infektuar pacientë imunodeficient, të ndjeshëm për një gamë të gjerë infeksionesh, lloje kanceri dhe sëmundjesh të tjera që njerëzit me sisteme të shëndetshme të imunitetit mund të luftojnë. Funksioni imun i organizmit matet nëpërmjet numërimit të qelizave të quajtura CD4.

Kategoritë e predispozuara

Grupet që janë në rrezik të lartë për t'u infektuar me HIV përfshijnë: burrat që kanë marrëdhënie seksuale me burra, ata që injektojnë drogë, të burgosurit dhe personat që jetojnë në mjedise të tjera të mbyllura, punonjësit e seksit e klientët e tyre dhe transjinorët. Popullatat kyçe shpesh kanë sjellje që rrisin vulnerabilitetin ndaj HIV dhe zvogëlojnë aksesin në programet e testimit dhe trajtimit. Për infeksionin HIV nuk ka shërim. Megjithatë, medikamentet efektive antiretrovirale (ARV) ndihmojnë për të kontrolluar virusin dhe për të parandaluar transmetimin, në mënyrë që njerëzit me HIV si dhe ata në rrezik të



madh për t'u infektuar, të mund të gëzojnë jetë të shëndetshme dhe produktive. Faza më e avancuar e infeksionit HIV është AIDS, i cili mund të zgjasë nga 2 deri në 15 vjet për t'u zh-



në varësi të fazës së infeksionit si: fryrje e nyjave limfatike, humbje e madhe në peshë, ethe/temperaturë, diarree e vazhdueshme, kollë.

Transmetimi i HIV

Transmetimi i HIV mund të ndodhë nëpërmjet shkëmbimit të

villuar, në varësi të individit.

Shenjat e AIDS

Megjithëse njerëzit që jetojnë me HIV prirën të jenë më infektues në muajt e parë, shumë prej tyre nuk janë në dijeni të gjendjes së tyre HIV pozitiv deri në fazat e mëvonshme. Javët e para pas infeksionit fillestar, këta persona mund të mos kenë asnjë shenjë ose mund të shfaqin shenja të ngjashme me gripin si ethe, dhimbje koke, skuqje apo dhimbje të fytit. Me dobësimin progresiv të sistemit imunitar, infeksioni përparon dhe një person mund të zhvillojë edhe shenja të tjera të cilat ndryshojnë

një shumëllojshmëri lëngjesh të infektuara të trupit të njeriut si gjaku, qumështi i gjirit, sperma dhe sekrecionet vagjinale. Disa nga sjelljet dhe kushtet që vënë individët në rrezik më të madh për t'u infektuar me HIV përfshijnë: marrëdhëniet seksuale vagjinale ose anale të pambrojtura; pasja e një infeksioni tjetër seksualisht të transmetueshëm si sifiliz, herpesi, klamidia, gonorrea dhe vagjinoza bakterore; shkëmbimi i mjeteve të kontaminuara si gjilpëra, shiringa e pajisje të tjera gjatë injektimit të drogës; marrja e injeksioneve apo transfuzioneve të gjakut të pasigurta, transplantit i organeve, si dhe

të rrezikut. Mënyrat kryesore për parandalimin e HIV, të cilat shpesh përdoren në kombinim me njëra-tjetrën përfshijnë: përdorimin e prezervativit, testimin dhe këshillimin për HIV dhe IST të tjera, rreth prerjen mashkullore mjekësore vullnetare (syneti), përdorimin e terapisë antiretrovirale (ARV) për parandalim, reduktimin e dëmit për përdoruesit e drogave intravenoze, eliminimin e transmetimit të HIV nga nëna tek fëmija.

Trajtimi i AIDS

Sot infeksioni HIV mund të kontrollohet nëpërmjet përdorimit të terapisë antiretrovi-




procedurat mjekësore me instrumente të mprehta të kontaminuara; shpimet aksidentale me gjilpërë. Individët nuk mund të infektohen me HIV nëpërmjet kontaktit të zakonshëm të përditshëm si puthjet, përqafimet, takimi i duarve, ose ndarja e objekteve personale, ushqimit apo ujit, etj.

Parandalimi i HIV

Individët mund të zvogëlojnë rrezikun e infektimit me HIV duke kufizuar ekspozimin ndaj faktorëve

të kombinuar, e cila përbëhet nga 3 ose më shumë barna antiretrovirale. Barnat antiretrovirale nuk kurojnë infeksionin HIV, por kontrollojnë shumimin e virusit brenda trupit të një personi dhe i mundësojnë sistemit imunitar të individit të fuqizojë kapacitetin për të luftuar infeksionet.

Mjekimi me ARV zgjat jetën e të sëmurëve dhe rrit cilësinë e saj, duke e shndërruar AIDS-in në një sëmundje kronike.



Këshilla

Udhëzime të vlefshme për t'u mbrojtur nga situatat e përmbytjeve

Në situata me reshje të mëdha shiu, dalje të lu menjve nga shtrati, prishje të urave e rrugëve, përmbytje të zonave të banuara, rrëshqitje dherash, dëmtime të godinave kërkohen masa specifike për të shmangur në maksimum dëmtimet dhe aksidentet që mund të na kushtojnë edhe jetën. Më poshtë po japim disa këshilla sesi të mbrohemi nga këto situata:

Për të shmangur dëmtimet nga rryma elektrike është e domosdoshme:

-Të bëjmë stakimin e automateve qendrore.
-Të qëndrojmë në vende të sigurta pa lagështirë.

-Mos ndizni pajisjet elektrike që janë lagur ose qëndrojnë në ujë.

-Mbani fëmijët sa më larg rreziqueve nga linjat elektrike, pajisjet elektrike etj.

-Mos përdorni gjeneratorë elektrikë në vende të mbyllura, gazrat që ato lëshojnë gjatë punës përbëjnë rrezik për jetën tuaj.

Informohuni vazhdimisht për gjendjen e relievit, gropat që mund të jenë formuar, rrymat e fuqishme të ujit, urat, rrëshqitjet e dherave.
-Qëndroni në vende ku jeni më të sigurt; në lartësi, në kate më të larta të godinave, në kodrina.

-Mos tentoni të kaloni përrenj, lumnej kur prurjet janë të mëdha.

-Shmangni lëvizjet mbi ura, në pellgje me ujë etj.

Në kushtet e lëvizjeve të domosdoshme, me ujëra të rrëmbyera, qëndroni pranë njëri-tjetrit dhe në grup.

Në kushtet e një moti të jashtëzakonshëm më të rrezikuarit janë fëmijët



-Mbajini fëmijët sa më pranë, nën vëzhgim të vazhdueshëm.
-Fëmijët nuk duhet të lëvizin të

pashoqëruar.
-Mbajini ata në vende të sigurta, në kate të larta, larg rrymave të

ujit, në vende ku mendoni se nuk arrijnë ujërat.
-Sigurojini ata me veshje të përsh-

tatshme.

Reshjet e shumta shtojnë mundësinë për aksidente, të cilat rrezikojnë jetën tuaj

-Shmangni në maksimum lëvizjet me mjete motorike në kushtet e motit të keq.

-Informohuni në vazhdimësi për vendin ku do të lëvizni, motin, reshjet, temperaturat.

-Kontrolloni gjendjen teknike të mjetit, karburantin, paketën e ndihmës së parë, pajisjet ndriçuese, gomat.

-Sigurojini veshjet për përshatshme për udhëtimin në këto kushte. Veshje të ngrohta, mbrojtëse nga reshjet e shiut, këpucë dimërore, çizme etj.

-Kujdes duhet treguar për shpejtësinë gjatë lëvizjes me makina.

-Vendosni fëmijët në vende të përshatshme, në sedilën e posaçme dhe të lidhur me rrip sigurie.

-Sigurojini që aparatet e celularit të jenë të karikuara, dhe me karikues rezervë në makinë.

-Mos tentoni të kaloni me mjetin tuaj në vende të dyshimta, me pellgje uji, prurje të mëdha, apo dhe me rrezik të lartë rrëshqitjeje.

Ndërtesat ku ju banoni e kryeni aktivitetet të ndryshme janë të rrezikuara

-Mos qëndroni në, mbi apo pranë godinave që janë të mbuluara nga uji.

-Gjatë punës për pastrimin e ambienteve të përmbytura bëni kujdes të përdorni doreza, vishni çizme, pasi mund të lëndoheni në çdo moment.



Opinion i Ditës

Nga Monika Shoshori Stafa

(Vijon nga faqja e parë)

30 NËNTOR 2017

... traumatizuan jo vetëm popullsinë që pësoi egërsinë e natyrës, por të gjithë vendin. Haraçi për t'u paguar ndoshta është më shumë se një e treta e buxhetit vjetor. Menjëherë qeveria ka premtuar se do të zhvendosë të gjitha familjet e prekura nga përmbytjet e ditëve të fundit. Gjatë mbledhjes së Komitetit të Koordinimit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile, kryeministri Edi Rama kërkoi nga ministrat dhe nga organet e tyre që të angazhohen me seriozitetin maksimal për të bërë gati faturrën e dëmeve dhe më pas për të nisur sa më parë procesin e kompensimit të familjeve, që janë dëmtuar nga reshjet e shiut e që sollën përmbytje në disa zona të vendit. Dhe njëherësh duhen përgatitur analizat për të avancuar më tutje me një program të qartë, që është në fakt vijimi i punës nisur dy vjet më parë - tha Rama, sepse këto përmbytje nuk janë njëherë në 100 vjet, por tani, mesa duket janë pjesë e jetës sonë të përvitshme apo përdy-trevitshme.

31 JANAR 2015

Shqipëria Jugperëndimore përbëti një prej përmbytjeve më të mëdha të dekadave të fundit. Reshjet e shiut vazhduan për rreth një javë dhe shkaktuan një rritje të papritur të nivelit të ujit përgjatë rrjedhës së Vjosës, Drinit, Osunit dhe Gjanicës, me një situatë më të rënduar në zonat e Vlorës dhe Fierit. Fatkeqësisht natyrore rrënoi e shkatërroi mijëra hektarë toka, mori me vete mijëra krerë bagëti e fundosi qindra banesa. Banorët, kryesisht fermerë me varkat e tyre "biblike", në shumicën e rasteve nuk ia dalën dot mbanë të shpëtojnë gjënë e gjallë që i ushqente. Për ta, gjithçka ishte dërrmuese, për të tjerët, shifrat u dukën tronditëse. Të prekur rëndë nga kjo situatë e pandodhur më parë, banorët shpjegonin gjatë një bashkëbisedimi me ta se edhe për bagëtitë e mbetura gjallë ishte e vështirë sigurimi i ushqimit. Historitë e tyre personale hapën faqet e para të mediave të huaja. Gjatë atyre javëve të ftohta të dimrit, shtëpitë e mbi tre mijë fëmijëve u përmbytën. Por veç frikës dhe pasigurisë, një pjesë e madhe përballë atë kohë përmbytjes edhe me mungesën në ushqime, rroba dhe shtëpi të ftohta e të lagështa. Shqipëria në zona të caktuara ishte përmbytur. Nuk do të mjaftonin vetëm ndihmat e shpejta të ditëve dhe netëve të vështira, por duhej marrë përsipër dhe çuar deri në fund një plan i plotë kthimi në normalitet, me synimin jo vetëm për të riparuar dëmet e shkaktuara në familjet e të gjithë kësaj zone, por edhe për të marrë masa konkrete për më programi investimesh në infrastrukturë. Atë kohë autoritetet u kërkuan ndihmë emergjente partnerëve ndërkombëtarë. Raporti i Vlerësimit të Nevojave pas Përmbytjeve u prezantua në muajin

prill të 2015. Ai identifikonte dhe vlerësonte nevojat për sektorët më kyç të prekur nga përmbytjet. Por situata e krijuar nuk ishte thjesht pasojë e reshjeve të vazhdueshme të shiut, por kryesisht e degradimit mjedisor, mungesës së menaxhimit të duhur të ujëmbledhësve, mungesës së vlerësimit të rrezikut në përdorimin e tokës dhe vendbanimeve si dhe dobësive sociale në rajonet e prekura. Delegacioni i BE-së në Shqipëri siguroi financimin e 6 milionë eurove për realizimin e

JANAR-SHKURT 2010

Për më shumë se një muaj rresht reshjet e shiut shkaktuan një muaj përmbytje masive në veriperëndim të vendit, e cila traumatizoi jo vetëm popullsinë që pësoi egërsinë e natyrës, por të gjithë vendin. Atë kohë u tha se haraçi për t'u paguar ishte gati sa një e treta e buxhetit vjetor. Shteti duhet të marrë jo më pak se 300 milionë euro borxh dhe njëherësh duhet të nxirrte në shitje gjithë pasurinë e mbetur publike, me përjashtim të digave të hidrocentra-

ndërtimeve pa rregull, për shkak të trilleve individuale në sjelljen me natyrën.

ANAMNEZA E PROBLEMIT

Shqipëria nuk mban, Shqipëria ndërton e rrëzon. Shqipëria rrëshqet në fushë e në mal, në rrugët kombëtare dhe në rrugët dytësore, në vepra publike dhe në ato private dhe të gjitha këto duken se krijojnë vetvetiu bindjen e frikshme se në këtë vend gjithçka është aksidentale. Si të thuash, je me fat nëse nuk del lumi nga shtrati

ret nga shpërfillja e ligjeve të saj, nga shfrytëzimi barbar pa menduar për brezin tjetër, nga shkatërimi i atyre që quhen raporte bazë të ekosistemeve të qëndrueshëm. Nuk është çështje edukimi mjedisor, as iluminizmi intelektual. Ekosistemet shkatërrohen për shkak të strategjive politike të shfrytëzimit të resurseve natyrore. Sa herë që këto ekosisteme janë prekur pa respektuar ligjet që rregullojnë qëndrueshmërinë e marrëdhënieve njeri-natyrë, hakmarrja ka qenë e rëndë. Dy herë është përmbytur Shkodra gjatë periudhës osmane, pikërisht për shkak të ndërhyrjes në regjimin natyror të ujërave, sepse qyteti i duhej shtuar një mulli: herën e parë sepse u devijua më shumë ujë prej Drinit plak në Drinasë dhe herën e dytë se u devijua derdha e përroit të Kirit. Mund të përfytyrohet lehtësisht tashmë se në ç'shallë janë shkatërruar ekosistemet gjatë dy dekadave të fundme. Natyra shqiptare është trajtuar sikur të ishte e armikut. Nuk ka mbetur lumë pa u mbjellë me fabrika prodhimesh ndërtimi, nuk ekziston ende një hartë e plotë e vendeve të depozitimit të municioneve masive në periudhën totalitare, në më shumë se dy dekadat e fundit janë shkatërruar edhe parqet kombëtare të vendeve më piktoreske të Shqipërisë dhe mbi të gjitha është shembur edhe bashkëjetesa e njeriut me mjedisin: më shumë se një e treta e popullsisë gjendet tashmë në Tiranë e Durrës, një e treta gjendet në mërgim dhe vetëm një e treta ka mbetur në prapatakën shqiptare. E çuditshme si natyra ende nuk është hakmarrë me ndonjë epidemi masive në qytetet e mbipopulluara, për shkak të pamundësisë së urbanizimit.

Po pse ka ndodhur e gjitha kjo? Sigurisht, jo se në tekstet shkollore nuk flitet për mëmën natyrë. As se autoritetet nuk e dinë se çfarë po ndodh. Sjellja armiqësore me natyrën dhe me burimet e saj po ndodh pikërisht sepse të gjithë, kush ka një mundësi për ta përdorur, sillen me natyrën njësoj si sillëshin të njëjtët dikur me pronën e përbashkët, pronë e askujt. Ky është thelbi: natyra gati-gati nuk është cilësuar një trashëgimi komuniste, ajo është pronë e askujt dhe gjithkush ka të drejtë të hapë kanalën e vet, të ndërtojë galerinë e vet, të shembë shkëmbin e vet, të presë pyllin e vet, të ndalojë lumin e vet.

Në të gjithë botën ekosistemet themelore njeri-natyrë janë cenuar. Al Gore, zëvendës-president i SHBA-ve për dy mandate, do të mbahet mend më shumë si fitues i çmimit Nobel me dokumentarin kushtuar fatit të globit në kushtet e tejshfrytëzimit dhe të pa-përgjegjësisë për të ardhmen, shprehur në rrezikun e mbingrohjes globale, të shkryerjes së akullnajave, të hakmarrjes së pritshme të natyrës. Dhe Shqipëria nuk është një ishull që mund të ketë fat më vetë larg këtyre rreziqeve. Sepse bota e sotme është kthyer në një "little village", ku ndikimet përcillen shumë shpejt jo vetëm atje ku rreziq është gjeografikisht afër, por edhe në dis-



këtyre veprave. UNDP mori përsipër realizimin konkret të tyre, duke kontribuar me 300.000 euro. Në atë projekt, Bashkimi Europian u angazhua shumë seriozisht për të identifikuar të gjitha dëmet dhe për të mbështetur një financim të konsiderueshëm në aspektin e rindërtimit, por me standarde tërësisht të reja të infrastrukturës si në zonat e Armenit, të Bishtit të Malit dhe Selenicës-Armen; në zonat Horë dhe Kallarat, Vranisht; në zonën Ceprat, Risili dhe Ceprat-Dheu i Bardhë; në zonat Bishan, Mifol Fitore dhe Novoselë; në zonat e Çervës; në zonat e Mashkullorës, Palokasrës dhe Shtupezit; në zonat e Gerhotit dhe në urën e Valaresë; në zonat e Vashhtëmisë e po ashtu në Lagunën e Nartës në Akërnj.

leve. Por hakmarrja e kaskadës së Drinit nuk mbaroi me aq. Përmbytja në veri ishte vetëm njëra prej pamjeve të hakmarrjes së natyrës. Dhe duke qenë se ishte më e madhja, bëri që të harrohen edhe shumë plagë të tjera. Në rrjedhën e Semanit dhe madje edhe të përroit të Gjanicës me javë e muaj gjendeshin të përmbytura dhjetëra shtëpi. Përmbytja preku edhe disa fshatra krejt në thellësi të vendit, në Tepelenë. U egërsua edhe diga e hidrocentralit të Banjës dhe alarmi u shtri mbi gjithë Dumrenë, madje tundej se në rast të një situatë të rënduar edhe Gramshi mund të përmbyte. Sikur të mos mjaftonte rreziq u çjven prej lumënjve, ja ku vijmë rend e rend të tjera shkatërrime: për shkak të galerive të minierave, për shkak të

të marrë shtëpinë, je me fat nëse nuk shembet faqja e malit dhe të të zërë brenda në tunel, je me fat nëse nën themelet e shtëpisë tënde nuk gjendet një galeri miniere, je me fat nëse aty pranë teje nuk gjendet një repart i paligjshëm dezaktivizimi të municioneve, je me fat nëse në malin përballë nuk gjendet ndonjë tunel i hershëm municionesh, je me fat nëse nishet dhe kthehesh shëndoshë.

Në të vërtetë, ajo që po ndodh nuk është diçka që lidhet me fatin dhe me rastësinë. Shqiptarët e kanë përgatitur vetë këtë hakmarrje. Sidomos në dy dekadat e fundme. Nuk është çështja se nuk kenkan në funksion një portë shkarkimi, disa hidrore të vjetër, argjinaturat po aq të mocme, një urë apo një kanal. Natyra hakmer-

Opinion

i Ditës

Pse dëmet janë gati katastrofike, sa herë Shqipëria njih reshje të mëdha shiu

Intervista me profesor Emin Musliu

Prof. dr. Emin Musliu është inxhinier i njohur në fushën e ndërtimit të veprave të mëdha energjetike në Shqipëri gjatë viteve '70-'80. Musliu ka pasur një aktivitet shumë të gjerë si drejtor teknik në kantieret e HEC-it të Selitës, drejtor i kantierit të ndërtimit të digës së HEC-it në Ulzë, kryeinxhinier gjatë viteve 1958-1960, drejtor i Institutit të Studimeve dhe Projektive të Hidrocentraleve dhe linjave të tensionit të lartë, të stacioneve dhe portave detare. Ai është projektues i HEC-it të Shkopetit, Bistricës 1, Bistricës 2. Ka mbajtur detyrën e zëvendësministrit të Ndërtimit, njëkohësisht duke e ruajtur këtë detyrë, i emëruar dhe drejtor i përgjithshëm i ndërtimit të HEC-it të Vaut të Dejës; drejtor i përgjithshëm i punimeve të HEC-it të Fierzës, deputet dhe ministër i Ndërtimit. Në një intervistë me të në shkurt të vitit 2010, prof. Musliu më shpjegoi se pse dëmet sa herë Shqipëria njih reshje të mëdha shiu janë gati katastrofike. Cilat janë ato arsye që qindra shtëpi, me të gjitha ato që posedojnë përfshi edhe bagëtitë, mijëra toka bujqësore dhe dhjetëra shkolla përmbyten çdo herë kur reshjet vijnë furishëm në qiellin shqiptar dhe jetë të pafund njerëzish vihen në rrezik? Kush e përballon këtë kosto dhe si mund të shpëtohet prej kësaj gjendjeje, që përsëritet në mënyrë të vazhdueshme për shqiptarët? A do të ketë ndonjëherë fund ky makth?

Përse janë egërsuar lumenjtë?

Lumenjtë nuk janë egërsuar. Kështu kanë qenë gjithmonë. Në vitin '56 kam qenë për herë të parë në Drin. Aty erdhi një prurje e madhe rreth 3000 m kub në sekondë. Në dhjetor '62 dhe janar '63 erdhi një prurje e jashtëzakonshme, me rreth 4500 m kub ujë në sekondë. Në atë kohë sapa filluam skemën për ndërtimin e Drinit. Na bëri përshtypje se u mbyt e gjithë fusha. Në vitin '70 kur ndërtoam hidrocentralin, në dhjetor përsëri na erdhi një prurje tjetër e madhe. Në '76, një tjetër prurje po e njëjtë, e madhe. Këto janë prurjet e zakonshme të lumit Drin dhe të Bunës. Po këtu nuk është problemi i këtyre prurjeve, problemi është se çfarë është bërë në këtë zonë gjatë këtyre 20 viteve? Shkodra në këto 20 vjet ka pësuar shumë ndryshime në pjesën fushore, janë prishur argjinaturat. Gjatë kësaj periudhe janë hedhur shumë mbeturina brenda, duke filluar nga rrënjët e pemëve, në të gjithë basenin e Drinit nga mbeturinat e letrave, janë blloku stacionat e pompimit, kanalet e derdhjes në det. Të gjitha këto kanë sjellë pengesa të mëdha në rrjedhën e Bunës. Tani me gjithë këto ndërhyrje që janë bërë, është bllokuar tërësisht, prandaj ndo-

dhin gjëra të tilla. Duhet kuptuar një gjë, me ndërtimin e hidrocentraleve në lumin Drin, erdhi dhe pakësimi i prurjeve të mëdha të Drinit. Nëse përpara kalonin deri në 4000 m/kub ujë në sek., me ndërtimin e hidrocentraleve në basenet e tyre kalon gjysma e sasisë së ujit. Kur kam dalë me mo-

shtyrë gjithmonë rrjedhën nga ne, duke na gërryer neve tokën. Është e domosdoshme që të merren masa të shpejta gjatë paneleve të lumit Buna për të mbrojtur tokën.

Sa i njohin autoritetet tona këto probleme?

Themelore për të shpëtuar nga përmbytjet është hartimi i një pro-

Ka një ishull pa emër në zonën e Shkodrës? Ç'është?

Ky ishull pa emër ndodhet në fund fare të Bunës është ishulli i Franc Jozefit, njëkohësisht është krijuar edhe një ishull tjetër, që mbeti pa emër se as jugosllavët s'i vunë emër dhe as ne. Po kjo është e vitit 1981. Është krijuar nga pru-

Në skemën e Drinit që kemi bërë në vitet '61-'63, ku u miratua ky variant që është në zbatim, janë marrë kritere të jashtëzakonshme për ndërtimin e këtij hidrocentrali. E para, është marrë një prurje me probabilitet një herë në 10 000 vjet, e dyta është marrë tërmeti deri në 9 ballë dmth., që të shkatërrohet e gjithë Shqipëria apo Europa, atëherë mund të ndodhin ato. Pra, po të ndodhë një gjë në kaskadën e Drinit, Shkodra dhe Lezha zhduken komplet. Brenda 4 orëve nuk mbetet gjë. Kemi të bëjmë me aftësitë e njerëzve për të gjykuar drejt mbi studimin dhe projektimin e këtyre veprave, të cilat duhet të kenë siguri maksimale. Ashtu si janë bërë nga projektuesit, ashtu mund të prishen vetëm nga njerëzit. Njeriu e ka dëmtuar shumë mjedisin, ka prurë të gjitha pyjet tona. Prerja e tyre është katastrofë e madhe, sepse krijon terren për erozion, pastaj nuk i mban dot njeri. Në kemi një fat të madh që jemi 28 mijë km katrorë si shtet, por baseni ujëmbledhës është shumë i madh, është 41.000 km katrorë. Uji është pasuria më e madhe që ka njerëzimi. Nëse nuk i trajton si duhet ujërat, të kthehen në fatkeqësi. Në studime kanë marrë pjesë qindra njerëz, inxhinierë të talentuar hidroteknikë, arkitektë, mekanikë, të cilët u ingranuan në një punë, e cila dha frytet e veta që do të vazhdonte edhe më tej. Këto tri vepra të Drinit janë ndërtoar për 19 vite, '67-'86. Në 24 vjet s'ke bërë asgjë, pse? Po ndodh një gjë tjetër shumë e keqe dhe e dëmshme për vendin tonë. Në kishim në vitin '61 deri '70 infrastrukturën më të fuqishme në Europë. Për studimin, projektimin, modelimin hidraulik ishin përcaktuar njerëzit më të shkëlqyer në atë periudhë, të cilët kishin studiuar brenda dhe jashtë vendit. Të gjitha u prishën në vitin '92. Instituti i Hidrocentraleve u prish, Ndermarja Gjeologji-Gjeodezi që kishte specialistë të shkëlqyer u prish. Laboratori i hidraulikës u prish, Instituti Hidrometeorologjik u prish, sikur nuk do kishim më punë me to. Dhe mbeti kjo me hamendjet e njëri dhe tjetrit.

Ju lëndon kjo situatë profesor?

Shumë. I kemi kushtuar jetën kësaj pune dhe kishim atë dëshirën e madhe që të ecte para vendi dhe të përmirësoheshin kushtet e punës në atë sistem që ishte. Është e dhimbshme kjo punë shumë, por kjo korrigjohet. Nuk janë gjëra që nuk korrigjohen kur ke dëshirën e mirë për të ecur para. Në guxuam në atë kohë, në '62 të hartonim dy hidrocentrale. Ishte një guxim i jashtëzakonshëm, por jo aventurë. Në '49-'51 ndërtoam hidrocentralin e Selitës. Unë isha përgjegjës teknik te Mali me Gro-pa. Ishim në tunel, nuk dija kujt i thoshin tunel, nuk dija çgjë, por në punë e sipër mësohet çdo gjë. shkurt, 2010

Bashkëbisedoi Monika Stafa



toskaf nga ana e palës jugosllave, kam parë disa gjëra të çuditshme. Kishin hedhur në anën e tyre pemë të rrëzuara, blloqe betoni, varka të kthyer përmby, të gjitha për të kthyer rrjedhën e Drinit në anën tonë. Se ka një rregull ndërkomëtar; mes i rrjedhës kryesore është kufiri. Kështu që ata kanë

jekt i detajuar për të zgjidhur të gjitha problemet. Duhet të hartohet preventivi përkatës, duhet bërë grafiku i punimeve për fazat më kryesore me mjetet dhe makineritë e nevojshme dhe moderne, si dhe kapacitetet njerëzore që duhen përdorur. Pa këto të katërta, fjala studim është e pa vlerë.

rjet e ndryshme që vinin në Bunë. Aty krijohet depozitimi dhe këto depozitime vit pas viti krijojnë atë ishullin që është pa emër atje.

Si hartuat ju një strategji kaq të guximshme, që rezultoi në ndërtimin e suksesshëm të disa hidrocentraleve kryesore në vend?

tronditës të hartës së Shqipërisë në duart e fuqive të mëdha, që janë gati ta copëtojnë me gërshtë sipas eko-interesave të tyre. Sot nuk janë fuqitë e mëdha që rrezikojnë që Shqipëria të mos mbajë. Sot është vetëm një fuqi e madhe që rrezikon: hakmarrja e merituar e mëmës natyrë.

← tancë. Mirëpo sot për sot Shqipëria po rrëshqet jo për një të keqe që i vjen nga rruzulli i sëmurë. Ajo po rrëshqet, sepse po ia bën të keqen vetes. Nuk është puna se pjesa më e madhe e pasurive natyrore janë të mbarueshme dhe çfarë do t'i mbetet brezit tjetër. Kjo do të ishte e keqja më e vogël. Më e madhja e keqe është në

mendësinë njerëzore, të trajtimin të natyrës si pronë kolektive komuniste. Dhe ç'mund të pritet në një situatë të tillë? Lumi, tunelet, digat, nëntoka, bregdeti, nuk mund të sillen me të mirë me shfrytëzuesit e vet, kur këta sillen me to me egërsi primitive. Jo industriale, me vetëdije shfrytëzimi. Në romanin "Viti i mbrapshtë" I. Kadare e për-

shkruan dhimbjen e një populli të dalë në pavarësi, që nuk e gëzon dot lirinë e vet, me vargjet:

*Shqipëri, pse shkri,
Shqipëri, pse s'mban,
Si lulja në prill,
Si bora në maj!*

Shkrimtari e shoqëron këtë poezi, të cilën e paraqet si një dhimbje popullore, me imazhin

Dje/në 'Deutsche Welle'

Frikë prej një gare të re armatimi?

Para 30 vjetësh Gorbaçovi dhe Reagani ranë dakord që të asgjësojnë raketat me rreze të mesme veprimi. Një ngjarje historike, që mund të shërbejë si shembull për t'iu kundërvënë shqetësimeve aktuale.

Në fund të viteve '70-të e në fillim të viteve '80-të bëhej fjalë për "ekuilibrin e tmerrit". Asokohe Bashkimi Sovjetik dhe SHBA-të zhvillnin një garë të pashembullt në histori armatimesh. Raketat me rreze të mesme veprimi të tipit "SS 20" nga njëra anë dhe "Pershing II" nga ana tjetër ishin kthyer në metaforat e konfliktit Lindje-Perëndim. Frika nga një luftë bërthamore ishte reale. Në Gjermani u krijua një lëvizje e re për paqen. Protesta e saj ishte në fakt e pasukses, sepse Bundestagu në fund të vitit 1983 vendosi që të dislokohen raketat me rreze të mesme veprimi në territorin e RFGJ-së.

Asokohe askush nuk e imagjinonte si të mundshme që pak vite më vonë do të mund të arrihej "marrëveshja e parë e çarmatimit pas 1045". Kështu u shpreh Bernd Greiner, drejtues i Kolegjit të Berlinit për Luftën e Ftohtë, në konferencën mbi Marrëveshjen INF (Intermediate Range Nuclear Forces Treaty) vendosur 30 vjet më parë me Bashkimit Sovjetik dhe SHBA-ve.

MARRËVESHJA INF NDODHET MBI BAZA TË LËKUNDURA

Parë në retrospektivë, shtrihet pyetja se "si ka qenë e mundur që të ratifikohet një marrëveshje e tillë?". Përgjigje për këtë në sfondin e "aktualitetit të politikës së ditës" mundohen të japin pjesëmarrësit në konferencën që vazhdon deri të shtunën (02.12) në Berlin.



Shpejt shtrohet në diskutim problemi i Koresë së Veriut dhe vazhdimi i provave me raketat bërthamore që kryen regjimi nën Kim Jong Un. Megjithatë, eksperti Greiner dhe të tjerë pjesëmarrës i referohen vazhdimisht çështjes se si që e mundur të vendoset marrëveshja INF para 30 vjetësh.

Rusia si trashëgimtare e Bashkimit Sovjetik duket se sot ka pak interes që ta zgjasë afatin e kësaj marrëveshjeje historike. Arsyeya është dislokimi i raketave me rreze të mesme veprimi në Kinë, Indi dhe në Pakistan. Edhe nga pala e SHBA-ve ka "mendime të ngas-hme" për t'u shkëputur nga marrëveshja INF. Në një sfond të tillë, Greiner shpreh shqetësim lidhur me politikën globale të sigurisë, "sepse debati për rrezikimin e mar-

rëveshjes nuk ka arritur në nivelin ku do të duhej të ishte".

NEVOJA PËR NJË POLITIKË SHTENSIONIMI

Por që bota ndodhet vërtetë para një gare të re armatimi, këtë e vë në pikëpyetje Susanne Baumann. Ajo është zëvendësja e së ngarkuarës së qeverisë për çështjet e çarmatimit dhe kontrollit të armatimeve. Megjithatë, disa shtete u kushtojnë një rëndësi krejt të re armëve bërthamore. Korenë e Veriut, Baumann e konsideron si "shembullin më të spikatur, se si një shtet përpiqet që të sigurojë vendin e vet në botë përmes zhvillimit të armëve bërthamore". Ajo thotë se situata e sigurisë në Europë "ka ndryshuar në masë me aneksimin e Krimesë". Armët atomike vitet e fundit kanë

fituar peshë në retorikën ruse. Por, ekspertja ka dyshim nëse "mund të bëhet fjalë vërtetë për një 'renukularizim'. Ndërsa Otfried Nassauer nga Qendra e Informacionit për Sigurinë Transatlantike në Berlin është më skeptik. Ai druan se mund të ketë një diskutim për armë atomike në Europë. Si dëshmi për këtë ai përmend programin e SHBA-ve për modernizimin e armëve të tilla. Otfried Nassauer i cilëson marrëdhëniet aktuale ruso-amerikane si një "raport klasik i një lufte të ftohtë". Ai rekomandon si zgjidhje thelbin e idesë së politikës socialdemokrate të shtensionimit që u aplikua në kohën e Luftës së Ftohtë kur Gjermania ishte e ndarë: "Përpara se të kritikojmë tjetrin, duhet të vihem njëherë vetë në pozitën e tij".



HOROSKOPI

DASHI

Do të nxiteni të bashkoni idetë dhe energjitë me ato të personave që janë në të njëjtën lartësi mendimesh me ju. Do të arrini shumë lart. Në fushën e dashurisë keni shumë mundësi, merreni në konsideratë, nuk do të pendoheni. Periudhë e shkëlqyer.

DEMI

Të mbështetur nga Hëna, dita do të jetë ogurmirë në profesion dhe nisat personale. Mund të mbështeleni ide të qarta. Çfarëdolloj propozimi që të bëni, do të ecë lehtësisht përpara për të pasur sukses. Me në fund, kishte ardhur koha!

BINJAKET

Strategjitë pak komplekse dhe pak të paqarta që po vini në zbatim nuk do të jenë efikase dhe pa një linjë veprimi konkret. Me Venusin dhe Marsin armiqësor qëndroni larg flirtimeve që i bëni thjesht për inat.

GAFORJA

Me Saturnin që ju mbështet do të keni të bëni më shumë me kënaqësinë sesa me punën. Do t'i zgjidhni çështjet e përditshme me efikasitet për t'u pasur zili. Në çështjet e dashurisë, do të keni një luftë të brendshme midis dëshirës për t'u shman-gur dhe nevojës për siguri.

LUANI

Marrini vendimet duke ruajtur ekuilibrin dhe duke shman-gur reagimet gjaknxehtë. Duhet patjetër të tregoheni të kujdesshëm. Nëse do t'ia lejon, një familjar do të jetë i lumtur t'ju ndihmojë. Mos e lënë t'ju ikë kjo mundësi.

VIRGJERESHA

Pozicionimi i Jupiterin ndaj Hënës bën që gjatë kësaj dite të mos jeni në humor shumë të mirë si dhe të jeni pak të shprehënduar. Prandaj mos u nxitoni dhe veproni me qetësi. Do të duhet pak kohë para se të zgjidhen të gjitha.

PESHORJA

Hëna krijon një premisë të shkëlqyer për anën profesionale. Intuitat e çastit do të bashkohen me aftësinë për të konkretizuar projektet. Do të vëzhgoni me vëmendje sjelljen e një personi që kërkon t'ju bëjë të besoni se është çfarë nuk është në të vërtetë.

AKREPI

Nëse Venusi ju jep sharm, Marsi do t'ju dhurojë energji dhe refleksë si fizike, ashtu edhe mendore. Pra, jeni në formë të shkëlqyer. Do të shfrytëzoni mundësitë që ju janë dhënë papritmas nga Urani, me ritme sa më të shpejta.

SHIGJETARI

Duhet të përballeni me një ndryshim të paparashkuar, që ndoshta në një moment të dytë do të dalë se është më fitimprurës se sa mendoni. Duke qenë shumë të ndjeshëm do të doni të rrethoheni nga gjëra dhe persona që ju kujtojnë kohë të kaluara.

BRICJAPI

Me Saturnin kundra, dashuria do t'ju godasë në mënyrë të parezistueshme, thellësisht, ndoshta edhe pak në mënyrë të misterhme, por e sigurt që do të jetë një përvojë e këndshme. Në punë bëni bilancin dhe verifikoni nëse jeni duke bërë atë që doni. Kërkoni gjithmonë për më mirë.

UJORI

Nëse në punë dikush do t'ju impononte këndvështrimin e vet pa marrë parasysh kërkesat tuaja, mos qëndroni të heshtur, ngrihi zërin! Do të jeni konstruktiv dhe entuziast, me ndikimin e Merkurit, që do të marrë inkurajimet e nevojshme nga Saturni.

PESHQIT

Urani do ta bllokoi disi ndikimin e Hënës dhe kështu do të lëvizni pak me vështirësi. Ndërkaq, nuk do t'ju mungojë rezistenca dhe pozitiviteti. Do të merrni në dorë një çështje që ka ngjitur dhe do t'ju jepni zgjidhje me një ndërhyrje të zgjar dhe të ekuilibruar.

Katovica

Formati i "Traktatit të Bukureshtit" në Beograd dhe Shqipëria

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

Çështja shqiptare dhe faktori shqiptar hyjnë ndër preferencat e pazareve të diplomacisë së fshehtë bizantine ballkanike.



... organizojnë dy samite të kryetarëve të shtetit dhe të qeverive, siç po veprojnë së bashku Serbia, Greqia, Bullgaria dhe Rumania. Në 8 dhjetor do të mblihdhen në samitin e tyre në Beograd Presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiq; kryeministri i Greqisë, Aleksis Cipras; kryeministri i Rumanisë, Mihai Tudose dhe kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov, në një kohë kur ata sapo kanë zhvilluar samitin e tyre të parë në Varna të Bullgarisë në 3 tetor 2017. Duke qenë se asnjë nga katër kryeqytetet e përfshira nuk po i rrëfen publikut vendës dhe rajonal se çfarë urgjence apo gjë e jashtëzakonshme ka ndodhur apo pritet të ndodhë, që i shty të mbyllën shpejt me njëri-tjetrin në një samit të dytë brenda dy muajve, analiza të çon tek pikëpyetje dhe dyshime normale. Sepse qoftë formati, qoftë koha e krijimit të grupimit, qoftë ngutja dhe axhenda, duket se dalin jashtë shtetit të integritetit evropian të rajonit dhe të bashkëpunimit të përgjithshëm ballkanik.

Samitet e udhëheqësve të shteteve nuk janë udhëtime turistike dhe duket se motive tepër të rëndësishme dhe të ngutshme duhet të shtyjnë qeveritë dhe diplomacitë e tyre të djersinë 24 orë në 24 për të organizuar samitet njëri pas tjetrit. Është një ngjarje diplomatike e veçantë dhe serioze, çka sinjalizon se aleanca e këtyre katër shteteve po ecën me shpejtësi të pazakontë. Një gjë e tillë në diplomaci zakonisht prodhon shqetësime, të cilat sugjerojnë vëmendje të veçantë nga të gjithë shtetet e tjera të rajonit, të cilët kjo aleancë e ngushtë sektare ballkanike i ka lënë jashtë, përfshirë edhe Shqipërinë.

Natyrshisht, katër shtetet e mësipërme kanë të drejtën të mblihdhen në samite edhe dy herë në javë për marrëdhëniet e tyre. Por kur rajoni ndodhet në kulmin e procesit të integritetit evropian, kur BE ofron perspektivën e anëtarësimit për gjitha shtetet ballkanike jashtë BE-së, kur Ballkanin po e joshin me projekte fantazmagorike për integrim rajonal e për familje ballkanike, duket nonsens të krijosh grupe dhe aleanca sektare, që në fund të fundit e pengojnë rrymën e integritetit dhe të bashkëpunimit global. Por, ajo që i shton më shumë dyshimet rreth karakterit të kësaj aleance sektare ballkanike është fakti që në rendin e ditës së samitit të Beogradit pritet të trajtohen çështje, të cilat u përkasin palëve të treta, pra shteteve të tjera ballkanike, që nuk janë të pranishme as në këtë grupim e as në këto samite.

Nga aq sa është botuar në mediat greke për rendin e ditës së samitit të Beogradit, tërheqin vëmendjen disa çështje. Portali grek "dailyhellas" dhe shumë media të tjera greke, lidhur me samitin botuan në 30 nëntor një informacion, i cili duke qenë i njëjtë, krijon idenë se vjen nga i njëjti burim zyrtar. Sipas këtij informacioni, "zhvillimet e fundit në Ballkanin Perëndimor do të jenë pjesë e bisedimeve, si dhe rrajtja dhe forcimi i stabilitetit dhe perspektiva evropiane e rajonit". Nuk mund të mos shtrosh pyetjen se ç'punë ka ky grupim i mbyllur ballkanik të diskutojë çështjet dhe zhvillimet e fundit në Ballkanin Perëndimor, pa qenë të pranishme vendet e Ballkanit Perëndimor. As BE, as NATO, as OSBE e as Këshilli i Europës nuk i ka ngarkuar këtij grupimi ndonjë rol të posaçëm gardianit apo tutorit të Ballkanit Perëndimor. Tri shtete nga katërshja nuk janë anëtarë të Ballkanit Perëndimor. Nga ai që quhet "Ballkan Perëndimor", vetëm Serbia është anëtare dhe duke diskutuar vetëm me Serbinë, duket sikur tri kryeqytetet e tjera kanë dëshirën t'i japin Serbisë mandatin e përfaqësimit të Ballkanit Perëndimor. Padyshim, Serbia e ndër-

ron këtë mandat. Asnjë shtet i Ballkanit Perëndimor nuk i ka dhënë Serbisë mandatin e përfaqësimit dhe ajo nuk mund të pretendojë këtë rol në bisedimet me partnerët e këtij grupimi sektar ballkanik.

Përsa i përket perspektivës evropiane të rajonit, është naive të mendohet se për këtë po mblihdhen me urgjencë dy herë brenda dy muajve udhëheqësit e katër shteteve. Perspektiva evropiane e Ballkanit është mandat dhe kompetencë e BE dhe jo e anëtarëve të vegjël e të varfër të BE nga Ballkani. Që nga viti 2014 është krijuar nga kancelarja gjermane, Angela Merkel mekanizmi i "Procesit të Berlinit" pikërisht për të shpejtuar dhe aranzhuar ritmet dhe modalitetet e integritetit evropian të Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të "Procesit të Berlinit" janë organizuar çdo vit që nga 2014-ta samitet e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Berlin, Vjenë, Paris, Trieste. Në asnjë samit të "Procesit të Berlinit" nuk është ftuar as Greqia dhe as Bullgaria e Rumania, çka don të thotë se ata nuk kanë as detyrën, as potencialin, as nivelin dhe ndikimin që të merren me detyrat madhore të BE-së.

Çështja tjetër, që sipas mediave greke do të trajtohet në samitin e Beogradit, është ajo e gazsjellësit Transadriatik TAP. Sipas "dailyhellas": "Projekte të mëdha zhvillimi si gazsjellësi TAP janë të një rëndësie të madhe dhe do të kryesojnë axhendën e samitit katërditor në Beograd". Nga katër shtete të këtij grupimi, vetëm Greqia është një shtet transitues i gazsjellësit TAP, kurse tre të tjerët nuk janë dhe nuk kanë lidhje me TAP-in. Nuk kuptohet se çfarë do të diskutonjë ballkanikët e samitit të Beogradit për gazsjellësin TAP, kur nuk janë të pranishëm as Turqia, shteti më i rëndësishëm i lidhjes së gazsjellësit TANAP me gazsjellësin TAP, dhe as Shqipëria, shteti kyç i ndërlikimit të gazsjellësit TAP me gazsjellësin Adriatik-Jonian, IAP. Greqia nuk është as shteti furnizues dhe as shteti financues apo ndërtesues i gazsjellësit TAP, pra nuk është një shtet vendimmarrës në gazsjellësin TAP.

As diplomacitë përkatëse dhe as mediat greke, serbe, bullgare e rumune nuk shpejtojnë se cili është boshti, që i lidh katër shtete e këtij grupi sektar ballkanik dhe që i ndan nga shtetet e tjera të rajonit. Nuk është e qartë se pse katërshja mendon se i ndihmon integritetit evropian të rajonit krijimi i aleancës së veçantë të katër shteteve të Ballkanit. Shtetet e rajonit, përveçse janë nën ombrellën e "Procesit të Berlinit", kanë edhe një organizatë të tyre rajonale SEECP, që organizon çdo vit samite të liderëve ballkanikë, që në rendin e ditës kanë perspektivë evropiane të rajonit. Për hir të së vërtetës, duhet thënë se prirja dhe iniciativat për krijimin e grupeve të veçanta të shteteve ballkanike, katërpalëshe apo trepalëshe, i takon diplomacisë greke, e cila mendon se kështu do të vendosë një rol drejtues të Greqisë në rajon.

Faktor në rajon bëhesh duke u shprehur me vendosmëri për çka ndodh në Ballkan dhe jo duke qëndruar si mumje në cep të odës ballkanike.

Shtytsat e krijimit të aleancës së samitit të Beogradit mbeten të errëta dhe në rastin më indulgent, mund të thuhet se shprehin mentalitetin e vjetër të shekullit të kaluar të krijimit të Ligave të ndryshme diplomatike ballkanike, Liga e shteteve të kategorisë së parë, Liga e shteteve të kategorisë së dytë, etj. Kjo frymë nuk mund të mos risjellë në kujtesë që, për rastësi ose jo, formati i kësaj aleance të re është formati i shteteve, që nënkshkruan "Traktatin e Bukureshtit" në 10 gusht 1913, pas mbarimit të luftës së dytë ballkanike, me pasojat e njohura negative për territoret ballkanike.

Ka shumë të panjohura në aktin e krijimit të kësaj aleance të re sektare ballkanike. Ajo që bie në sy në emëruesin e tyre të përbashkët është se kanë boshthet e përbashkët që janë shtete ortodokse. Ja çfarë shkruante "bulgarianpresidencyeu" lidhur me samitin e parë të katërshes: "Kryeministri bullgar, Borisov ishte mikpritësi i mbledhjes me liderët e Rumanisë, Greqisë dhe Serbisë, e cila u quajt shpejt nga diplomatët 'katërshja ortodokse'. Fryma e bashkësisë fetare ortodokse ishte dhe nxitësi i krijimit të grupit të mëparshëm sektar ballkanik midis Serbisë, Bullgarisë dhe Rumanisë në 24 prill 2015, që ata e emërtuan 'Grupi i Krajovës'. Krijimi i aleancave të shteteve ballkanike mbi bazën fetare ortodokse është një strategji e diplomacisë së Rusisë për rajonin, e projektuar si kundërvënja e integritetit

europian.

Ka rëndësi që Shqipëria t'i ndjekë me vëmendje këto zhvillime, sepse ka shumë përpjekje për ta tuar atë me produkte të diplomacisë meskine ballkanike, të cilat gjatë 105 viteve të shtetit shqiptar kanë synuar ta mbajnë në statusin e shtetit të kategorisë së dytë, për të mos thënë të shtetit raja. Nuk mund të mos bëjë përshtypje që në këtë grupim të ri shtetesh ballkanike, ku Shqipëria nuk është ftuar dhe është përjashtuar njësoj si në aleancat e shteteve ballkanike para Luftës së Parë Botërore edhe midis dy luftërave botërore, ka tri shtete anëtare të NATO-s, për të cilat Shqipëria në bazë të Traktatit Atlantikut Verior duhet të hyjë në luftë nëse dikush i sulmon. Dhe këto tri shtete të NATO-s dashkan ta forcojnë stabilitetin në Ballkan pa anëtarët e tjerë të NATO-s në rajon, pa Shqipërinë, pa Turqinë, pa Kroacinë, pa Slloveninë dhe pa Malin e Zi. Me tri nga katër shtetet e samitit të Beogradit, Shqipëria ka nënkshkruar Traktate Miqësie dhe Bashkëpunimi, me Greqinë, me Bullgarinë dhe me Rumaninë, fakt që e bën edhe më të habitshëm përjashtimin e Shqipërisë nga kjo tavolinë e ngushtë. Element negativ, që del nga formati i samitit të Beogradit është se nga katër shtete të tij, tri shtete nuk e njohin Kosovën dhe Serbia çdo ditë rivendikon territorin e saj, njësoj si në kohën e "Traktatit të Bukureshtit".

Në këtë situatë konfuze ballkanike, Shqipëria nuk mund të rrijë indiferente, sepse këto re të errëta nuk po krijojnë në Indokinin, por në Ballkan. Edhe një nxënës i fillorës e din se çështja shqiptare dhe faktori shqiptar hynë ndër preferencat e pazareve të diplomacisë së fshehtë bizantine ballkanike. Shqipëria ka të drejtën të kërkojë të informohet në kanale diplomatike, të paktën nga tre anëtarët e NATO-s se çfarë po ndodh në tryezat e veçara ballkanike. Shqipëria ka të drejtën t'u kërkojë tri shteteve me të cilat ka nënkshkruar Traktate Miqësie, se çfarë po ndodh. Shqipëria ka të drejtën ta përfshijë edhe NATO-n në kërkimin e shpjegimeve për arsyet e krijimit të kësaj aleance sektare ballkanike. Shqipëria duhet të marrë shembull nga Kroacia, anëtare e NATO-s, e cila e shprehu menjëherë dhe hapur në nivelin më të lartë të ekzekutivit dyshimin dhe protestën lidhur me aleancën e re sektare ballkanike. Dhe kaq e fortë ka qenë protesta e Kroacisë, sa që në datën 20 tetor kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov u detyrua të pohojë në konferencë shtypi se kryeministri i Kroacisë i kishte kërkuar atij arsye përse nuk ishte ftuar Kroacia në grupimin e ri.

Formati i "Traktatit të Bukureshtit", që po mblihdhet në samitin e tij të dytë në Beograd, nuk mund të mos lërë shije të hidhur. Ai mjafton si një sinjal i ri historik dhe diplomatik që Shqipëria duhet të shikojë përtej retorikave ballkanike për paqen dhe harmoninë rajonale dhe përtej karremave për mikro-federata ballkanike. Shqipëria duhet të shërojë sa më parë sëmundjen e saj të përjetshme të internacionalizmit, që e ka penguar të vendosë raporte reale barazie me shtetet e tjera në Ballkan. Shqipëria duhet ta thotë me forcë fjalën e saj për zhvillimet diplomatike në rajon. Faktor në rajon bëhesh duke u shprehur me vendosmëri për çka ndodh në Ballkan dhe jo duke qëndruar si mumje në cep të odës ballkanike. Në kohën e "Traktatit të Bukureshtit", shtetet ballkanike e shkëlqen neutralitetin e tij dhe e bënë shesh luftë dhe treg pazaresh midis tyre për territoret shqiptare. Sot, që është anëtare e NATO-s dhe në rajon ka dy shtete shqiptare, nuk s'justifikim për asnjë formë inferioriteti dhe kompleksitet shtetëror e diplomatik.

Paraqitje historike e Romela Begajt në Botërorin e peshëngritjes, që po zhvillohet në Anaheim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në kategorinë deri 69 kg, shtangistja kuqezi fitoi medaljen e artë në stilin e shkëputjes, duke i realizuar të tria provat me peshën përfundimtare 107 kg, ndërsa në shtytje ishte e pesta me 128 kg. Gjithëse, në dygarësh me 235 kg, u rendit e dyta në botë,



Ar në shkëputje dhe argjend në dygarësh

E mrekullueshmja Romela Begaj shkëlqen në Botëror

duke fituar medaljen e argjendë. Një rezultat i jashtëzakonshëm për 31-vjeçaren shqiptare, që shënon emrin me shkronja të arta në historinë e peshëngritjes shqiptare, si e vetmja që i ka dhuruar vendin medaljen e artë në Botëror. Gara e Begajt në sti-

lin e shkëputjes ishte perfekte. Në provën e parë ngriti 103 kg, më pas shtoi 2 kg në shtangën e saj, duke e realizuar me sukses provën e dytë, ndërsa në të tretën provoi 107 kg, për të siguruar medaljen e artë, me 1 kg më shumë se rivalja kolumbiane. Më të njëjtin strategi

nisi provën e saj edhe në dygarësh. Edhe pse fillimisht kishte deklaruar 130 kg, në tentativën e parë e uli në 125 kg, duke e realizuar me sukses. Në provën e dytë Begaj bëri mrekullinë duke ngritur 128 kg, por u pa qartë se problemi fizik që shfaqti në fund të provës së

parë ishte rënduar. Tentoi 131 kg në provën përmbylëse, por nuk ia doli. Pavarësisht se nuk ishte e saktë në të tria provat në shtytje, gara e Romelaj Begajt ishte e mrekullueshme. Në kategorinë deri 85 kg për meshkuj, Krenar Shoraj u rendit i gjashti me 145 kg në shkëputje, duke realizuar vetëm provën e parë, teksa dështoi në dy provat e tjera me 150 dhe 152 kg, ndërsa në shtytje nuk mori pjesë në konkurrim.

Spektakël i kurbinasve, që përmbysin disavantazhin pas golit të Gocajt dhe mposhtin Villazninë

Partizani dhe Laçi, suksese në transfertë

Të kuqtë dominojnë 3-0 Lushnjën në "Roza Haxhiu"



Jeton Selimi

Partizani kthehet duar plot nga "Roza Haxhiu", teksa tre gola në pjesën e dytë kanë bërë që të kuqtë të thejnë Lushnjën dhe të vijnë serinë e rezultateve pozitive. Pjesa e parë ishte e luftuar, por kushtëzohet shumë edhe nga shirat e dendur. Në minutën e 10, Partizani ka një rast të mirë shënimi. Progni kontrollon topin në zonën lushnjare dhe godet, por topi devijohet lehtë, prek shtyllën dhe del jashtë. Në minutën e 21-të miqtë protestojnë për një penallti pas ndërhyrjes ndaj Kalarit, por Remzi Sadiku vijon lojën. Në minutën e 37-të Lushnja i shkon shumë pranë golit të avantazhit, kur pas harkimit të Endri Maganit, topi shkon drejt portës me Hoxhën të mposhtur, por sipër vijës fatale është Atanda që largon. Minuta e 41-të dhe pranë golit është Partizani. Asani hedh bukur një top në zonë nga këndorja, Progni godet me kokë, por gjen vetëm shtyllën. Pjesa e parë mbyllet me rrjeta të papekura, ndërsa e dyta nis me Partizanin në sulm. Në minutën e 53-të të kuqtë mund të kishin përfutur nga një gabim i mbrojtësit të Lushnjës, por portieri Spaho korrigjon gjithçka, ndërsa pak minuta më pas është Trashi që thërret në apel Spahon, por gardiani reagon shumë mirë. Dhe nga këndorja e fituar, Partizani do të shënojë golin e parë. Trashi harkon në zonë dhe në qendër shfaqet Idi Batha, që zhbllokon rezultatit falë një devijimi fitues. Me golin e shënuar, Partizani bëhet me "krahë". Në minutën e 73-të Progni ka mundësinë e tretë, por ndryshe nga dy gjuajtjet e para që shkuan shtyllë jashtë, goditja e tretë nga distanca shkon shtyllë, gol, me mesfushorin që feston i çirruar. Por të kuqtë nuk e lenë me kaq. Lushnja është e dorëzuar tashmë dhe në minutën e 83-të vjen goli



i Lorenc Trashit, që nuk feston ndaj ish-skuadrës së tij. Mbyllet 3-0 në "Roza Haxhiu" me Partizanin që merr fitoren e pestë në kampionat dhe ngjitet në kuotën e 18 pikëve, ndërsa Lushnja mbetet edhe këtë javë e fundit me 5 pikë.

"QESH" LAÇI

Laçi ka shkëlqyer në "Loro Boriçi", ndonëse e nisi ndeshjen në tatëpjetë. Minuta e 6-të dhe Olsi Gocaj harkon nga djathta në zonë, aty ku Edon Hasani gjuan në volej dhe ndëshkon Selmanin me një gol shumë të bukur. Laçi kundërpërgjigjet fort dhe ka disa mundësi shënimi përpara se të vijë minuta e 43-të, kur Uzuni fiton një 11-metërs në dyluftimin e tij të shpejtësisë me Sherrin. Te pika e bardhë paraqitet Rexhinaldo, që ekzekuton saktësisht dhe sjell barazpeshën në "Loro Boriçi". Por fundi i pjesës së parë është vërtet i nderz, pasi është Villaznia që pretendon një 11-metërs pas një prekjeje të topit me dorë nga Uzuni, por kryesori Andi Koçi vijon lojën. Pjesa e parë mbyllet në barazim, ndërsa në të dytën Laçi ka mundësinë e dyfishimit në disa mo-

mente, por do ta vulosë vetëm 3 minuta nga fundi. Uzuni gjen fundoren nga e djathta dhe pason në hyrje të zonës, aty ku Lushkja nuk fal dhe shënon golin e epërsisë. Villaznia, që ka bërë shumë pak në këtë ndeshje,

shpreson më kot nga këmbët e Vucajt në minutën e 90-të, por mesfushori gjuan jashtë. Mbyllet 1-2 në "Loro Boriçi", me Laçin që ngjitet në kuotën e 18 pikëve, ndërsa Villaznia me 12 pikë mbetet në ujëra të turbullta.

Kuqezinjtë u turpëruan të dielën

Ndëshkoi Milanin, flet portieri i Beneventos: Mbylla sytë dhe...



Serisë A i mungonte prej 16 vitesh një portier goleador, derisa në skenë doli sot Alberto Brinjolli. Portieri i Beneventos u bë i pari që gjen rrjetën që kur Taibi kishte realizuar në këtë kampionat në vitin 2001, duke pasur një kënaqësi të dyfishitë pasi, i dha pikën e parë historike ekipit të tij në këtë edicion, për më tepër përballë Milanit. "Është aq e vështirë dhe e pabesueshme të mendosh të zgjidhësh një ndeshje në fund sa që nuk

thënë asnjëherë asnjë fjalë që nuk duhet, por sidomos për qytetin, që po jeton për herë të parë entuziazmin dhe mbështetjen që na jep në çdo ndeshje", ishin fjalët e portierit të emocionuar pas përfundimit të ndeshjes. Si shënova? Nga pankina ma bënë me dorë të dilja të kërceja dhe unë i thashë vetes se nuk kisha çfarë të humbisja më dhe po e provoj. Mbylla sytë dhe u hodha si portier, jo si sulmues dhe doli një gol i çmendur, është e pabesueshme".

më duket e vërtetë që ndodhi. Jam i lumtur, pasi presidenti e meriton, pasi nuk ka


TRAJNERI I PARTIZANIT



Starova: Pavarësisht rezultatit, ndaj Lushnjës nuk ishte e lehtë

Trajneri i Partizanit, Sulejman Starova, ka vlerësuar atë që dhanë të tijtë në fushë ndaj Lushnjës, ku fituan 0-3. Ai pranon se goli e çliroi ekipin, ndërkohë që përsërit thënien e tij se kampionatit tani ka nisur për Partizanin. Kreu i klubit të kuq u shpreh se Progni dhe Bardhi janë dy nga sulmuesit më të mirë në Shqipëri: "Ishim përgatitur shumë mirë, pasi e dinim se do të luanim me një kundërshtar të fortë. Lushnja ka luajtur futboll të mirë. Me Flamurtarin ka humbur në kohën shtesë. Ishim në kërcënimin e kundërsulmit në pjesën e parë, por goli i parë na çliroi. Jemi në ekulibër tani për golat e shënuar dhe të pësuar. Kemi marrë tri pikët dhe kemi rritur moralin. Për skuadrën tonë është faza e parë dhe duhet të marrim sa më shumë pikë. U shpërblyem për lojën që zhvilluam në këtë ndeshje. Bardhi dhe Progni janë dy nga sulmuesit më të mirë në Shqipëri. Kemi lojtarrë të tjerë, presim nga Sukaj dhe Fili. Kemi konkurrencë të madhe në mesfushë me ardhjen e Asanit. Ta bëjmë skuadrën në frymën e konkurrencës, që të arrijmë rezultate të mira. Merkatot? Kemi alternativa dhe merkatot është çështje tjetër. Kontingjentin e kemi, kemi grup të plotë. Janari do të sjellë lojtarrë për ambicent që ka presidenti Demi për të bërë një skuadër kompetitive", - theksoi trajneri Starova për "Supersport".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Bëjnë arte me re.
2. Krijoi Arsene Lupin (inic).
3. Janë forma.
10. Në hyrje të plazhit.
11. Kapen të parat.
13. Janë ufo.
14. Mbahen nga ata që i thyejnë.
18. Inicialet e Mascagni-t.
19. Në krye të trupave.
20. Eshhtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
22. Pak hemorragji.
23. U shkrua nga Jack London.
25. Institucione Ndërkombëtare Europiane.
26. Scarlet e Bashkë me erën.
27. Janë tituj në ekran.
29. Eric aktor.
31. Kështu e ka syrin vigjilent
32. Janë nofka.
35. Një provë... inteligjence.
37. Mund të jenë me sahat.

VERTIKAL

1. Malet pa kufij.
2. Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
4. Inicialet e Altman.
5. Një sportist që arrin majat
6. Courier ish-kampion i tenisit.
7. Fillojnë testin.
8. Mund të jetë parabolike.
9. Bie me ballë.
10. Carnera, ish-kampion i ringut.
11. Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
12. I kanë rrënjët në tokë.
15. Eshhtë pushkë.
16. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
17. Takim Brezash Durrës.
21. Ishtë lumi i Elizit
22. Eshhtë kardinal.
24. Mbyllin një krah.
28. Artikull anglez.
30. Mbyllin fushatat.
31. Partia pa ara.
32. Zola që shkroi Nana
33. Nganjëherë duhen vënë mbi i.
34. Një fjalë kastile
36. Inicialet e Mann shkrimtar.
39. Maiden që këndojnë.
41. Ai i shtatë është kinemaja.
43. Fillojnë arsyetimin.
45. Eshhtë nënë e Tironës.
46. Eshhtë shahu i fundit.
48. Inicialet e Klee piktor.
49. Dy asa.
50. Mbarojnë fare


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL:


1. Patricia këngëtare.
5. I vocërr ai i Migjenit
9. Hari spiune.
12. Qyteti i Robespierre.
14. Phineas i famshëm i cirkut.
16. Pak latinisht.
17. Inicilet e Banderas.
19. Janë tek në rrota.
20. Pak efikasitet.
22. Eshhtë shkolla fillore.
24. Arrihet duke aderuar
27. Pak iniciativë.
28. Një... art i Don Judd.
29. U kompozua nga Rachmaninov.
31. Diku në qendër.
32. Një është për të lidhur.
33. Jepet për hartim.
35. Sergej, poet i famshëm rus.
37. Veriu pa kufij.

VERTIKAL:


9. Fillojnë muzikën.
10. Një kontinent i ri.
11. Eshhtë për medaljen e parë.
13. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve.
15. Provinca e boerëve.
18. Eshhtë qyteti i njëmbjnjë dritareve.
21. Eshhtë dukuria.
22. Eshhtë hidrokarbur.
23. Griffith aktore.
25. Qe perëndësia e fitores.
26. Mbeten në fund.
30. Tregon çmimin.
34. Këndohet në opera.
36. Para Fe në New Mexico.
37. Eshhtë princ arab.
38. Tony që këndon Quando, quando, quando.
40. Bën mëza.
45. Pak tolerante.
47. Modem pa zë.
48. Pak marramendëse.
50. Mbyllin një dygan.
52. Fillojnë teorikisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	5			1	7	3			
8				4	9	5			
7	1	2	3						
5		1		7			6		
	2		4		8		9		
	9			6		8		7	
					7	9	5	6	
		6	5	8					2
1	3		6				4		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	5	4	7	1	9	3	8	2	
1	7	9	3	2	8	6	5	4	
3	8	2	5	6	4	7	9	1	
8	2	3	4	5	6	9	1	7	
5	4	6	9	7	1	8	2	3	
7	9	1	8	3	2	5	4	6	
9	1	7	2	8	3	4	6	5	
2	3	8	6	4	5	1	7	9	
4	6	5	1	9	7	2	3	8	

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3	19	K	U	L	T	M	A	P	L	A	B		
6	4	1	3		11				13	18	13	O	R	E	K	A	S	T	I	L	E	R	
13		4	3	2	4	3	2	4	5	3		R	U	L	A	K	T	O	R	I	A	L	E
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3	18		B		K	L	E	O	P	A	T	R	A	
13	5	11	6	4	5	10	3	5	3	14	4	I	E	K	I	T	R	E	T	E	S		
19			3	2	16	1	4		2	3	2	L	A	M	E	K	E	R	M	A	T		
7	4	6	14	5						1	11	T	E	R	M	A	T	A	R	I	C	E	
8	11	1	6	11	14		2	2	18	11		O	T	O	S	C	A	R	I	R	M	A	
3	2	10	3	2	11	6		18	4	4	2	B	R	E	D	H	I	A	I	R	K		
18	8		4		5	7	6	14	6	3	5	I	L	E	I	N	E	P	H	I	L		
15	2	3	2	11		2	11	6	5	10	5	A	N	A	L	I	T	I	K	E	A	M	I
5	3	2	14	2	3		7	2	3	5	3	S	E	T	E	S	K	I	C	A	T	O	

Argëtim filozofik

- Stili është një mënyrë e thjeshtë për të thënë gjëra të komplikuar. (Zhan Kikto)
- Çdo njeri është gjeni të paktën një herë në vit, një gjeni i vërtetë ka ide origjinale gjithnjë të pranishme. (G.C. Lichtenberg)
- Pranojeni vendin që ka caktuar për ju i plotfuqishmi, shoqëria e bashkëkohësve tuaj dhe lidhja midis ngjarjeve. (Ralf Valdo Emerson)

Thënie të mënçura

- Nga diamantet nuk lind asgjë, nga dheu lindin lulet.
- Urrëjtja nuk ndalet nga urrëjtja, në asnjë kohë; urrëjtja pushon nga dashuria: ky është ligji i përjetshëm.
- Njëqind vite të jetës së një njeriu që nu merr në konsideratë Ligjin Suprem, është e krahasueshme vetëm me 1 ditë të jetës së atij që e respekton.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	K	U	T	E	R	I		T	I	M
A	G	A	R	R	E	N	D	M	I	K	E
L	I	T	A	R	E	T	E	S	O		R
E	M	I	L	E	A	P	E	L	I	M	I
E	L	E	D	E	P	O	Z	I	T	A	T
A	T	E	K	A	P	A	N	O	N	E	T
L	S	K	A	N	A	R	I	N	E	A	M
E	S	S	E	N	D	A	M	E	A	N	A
C	L	P	A	M	I	T	E	E	M	E	R
M	I	K	A	T	E	T	E	T	E	I	
K	O	R	I	K	U	K	O	L	L	A	
U	N	A	Z	A	R	E	N	D	O	R	E

FJALËKRYQI (1)

M	I	R	A	N	D	A	B	I	S	H	T	I	
I	R	A	A	R	M	A	D	H	I	D			
T	O	A	P	A	R	E	T	E	T	A	E		
I	N	R	I	M	O	T	E	T	U	M	A		
I	R	D	A	M	A	R	E	T	I	L			
I	A	K	O	T	A	N	I	O	D				
M	K	A	B	I	N	E	T	E	R	A	R		
P	U	R	T	E	K	E	T	E	N	T	I	K	E
P	E	R	S	E	T	I	N	T	I	M			
L	A	O	T	G	O	L	A	L	A				
I	H	R	T	P	E	T	E	R	I	K			
V	O	L	E	L	E	N	D	E					

FJALËKRYQI (2)



www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

